FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.qpz.gov.al

Akte të papublikuara Ekstra 36 2009

Vendim i KM nr.1535/1, datë 26.11.2008	Për tjetërsimin e pronësisë shtetërore të truallit nga pronë shtetërore në pronë private, për "Colacem Albania", sh.p.k.....	3
Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 7.7.2009	Aplikimi nr.25336/04 "Çështja Grori kundër Shqipërisë"..	4

VENDIM
Nr.1535/1, datë 26.11.2008

PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE TË TRUALLIT NGA PRONË SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, PËR "COLACEM ALBANIA", SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 3, shkronja "b", e 8, paragrafi i parë, të ligjit nr.7890, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tjetërsimin e pronësisë shtetërore, me sipërfaqe 5760 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) m^2 dhe 36 415 (tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) m^2, në administrim, përkatësisht, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe bordit të kullimit, Lezhë, sipas genplanit/planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga pronë shtetërore në pronë private, për "Colacem Albania", sh.p.k.
2. Pagimi i çmimit nga "Colacem Albania", shpk-ja, do të bëhet në natyrë, me sipërfaqen e lirë të truallit, prej 43 175 (dyzet e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) m^2, që ka në pronësi kjo shoqëri.
3. Pronësia e truallit t'i kalojë nga organi, që e ka në administrim, "Colacem Albania" sh.p.k., përmes një kontrate tjetërsimi mbi pasuritë e paluajtshme, nënshkruar nga të dyja palët, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve për të nënshkruar kontratën e shkëmbimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA GRORI K. SHQIPËRISË

(APLIKIMI NR. 25336/04)

VENDIM

STRASBURG

7 korrik 2009

Ky vendim merr formë përfundimtare në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Vendimi mund të jetë objekt rishikimesh redaktimi.

Në çështjen Grori k. Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), i përbërë nga trupi gjykues:

Nicolas Bratza, kryetar
Josep Casadevall
Giovanni Bonello
Kristaq Traja
Ljiljana Mijović
Ján Šikuta
Päivi Hirvelä, gjyqtarë,
dhe Lawrence Early, sekretar i Seksionit,

pas shqyrtimit të çështjes në seancë të mbyllur më 27 nëntor 2007, 20 janar 2008 dhe 18 qershor 2009,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili është miratuar në datën e fundit.

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në aplikimin (nr. 25336/04) kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Kryesore të Njeriut (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar, z. Arben Grori ("ankuesi"), në datën 9 korrik 2004.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z.A.Kasapi, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj. S. Mëneri.

3. Ankuesi pretendon se, në veçanti, gjykatat shqiptare kishin vendosur për burgimin e tij, duke konvertuar një vendim të dhënë nga gjykatat italiane, në shkelje flagrante të kërkesave ligjore që rridhnin nga ligjet në fuqi në atë kohë. Ai bazohet në nenin 3, nenin 5 § 1 (a), nenin 6 § 1 dhe nenin 7 të Konventës dhe nenin 2 të protokollit nr. 7 të Konventës.

4. Më 6 shtator 2005, Gjykata vendosi ta njoftonte qeverinë për aplikimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi ta shqyrtojë themelin e çështjes në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e saj.

5. Më 7 dhjetor 2004, aplikimit iu dha përparësi, sipas nenit 41 të rregullores së gjykatës.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1971 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim të përjetshëm dhe me 15 vjet heqje lirie në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit (Shqipëri).

A. Baza e çështjes

7. Më 6 tetor 1997 autoritetet italiane lëshuan një urdhërarresti për ankuesin, duke e akuzuar për vrasje me paramendim të një nënshtetasi shqiptar në Milano, Itali.

8. Më 2 shkurt 2001, ankuesi u dënua në mungesë (*in absentia*) me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) për vrasje dhe me pesë vjet heqje lirie për armëmbajtje pa leje.

9. Më 16 shkurt 2001, autoritetet italiane lëshuan një fletarresti të dytë për ankuesin, lidhur me një akuzë të re kundër tij, për pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Nga dokumentet në dosje del se gjatë periudhës së proceseve në gjykatat italiane, ankuesi kryente një biznes të ligjshëm dhe banonte në Shqipëri.

10. Më 29 prill 2001 Interpoli i Shqipërisë i transmetoi policisë së Tiranës dy fletëarrestet e përmendura më lart. Në të njëjtën datë, shefi i policisë kriminale të Tiranës urdhëroi "zbatimin e menjëhershëm të fletarrestit".

11. Më 30 prill 2001, Interpoli i Romës u dërgoi një faks autoriteteve shqiptare duke u kërkuar fillimin e proceseve penale kundër ankuesit për krimet e kryera në territorin italian.

B. Proceset penale për akuzat për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike

1. Arrestimi fillestar i ankuesit

12. Më 30 prill 2001, ankuesi u ndalua në Shqipëri mbi bazën e fletë arrestit të lëshuar më 16 shkurt 2001 nga gjyqtari hetues i Gjykatës së Apelit të Milanos. Akuza lidhej me përfshirjen e ankuesit në një organizatë kriminale dhe me trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

13. Më 1 maj 2001, ankuesi u mbajt i ndaluar në paraburgim për 15 ditë në pritje të vendimit të gjykatës.

14. Më 12 maj 2001, gjykata e rrethit të Tiranës, ("Gjykata e Rrethit"), rrëzoi ankimimin e ankuesit kundër arsyeve të ndalimit të tij. Të njëjtën ditë, prokurori e informoi ankuesin rreth akuzave të ngritura kundër tij, që ishin pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikimi ndërkombëtar i lëndëve narkotike.

15. Më 15 maj 2001, gjykata e rrethit pranoi parashtrimin e prokurorit dhe urdhëroi burgimin e ankuesit për një periudhë të pacaktuar. Më 4 qershor 2001, Gjykata e Lartë e pranoi vendimin.

16. Në qershor dhe dhjetor 2001, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm i kërkoi në mënyrë të përsëritur autoriteteve italiane të dërgonin prova që mbështesnin akuzat kundër ankuesit. Në janar 2002, kërkesa u përsërit dhe nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë.

2. Fillimi i proceseve penale

17. Në 30 korrik 2002, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm filloi proceset penale në gjykatën e rrethit të Tiranës, duke e akuzuar ankuesin me trafikim të lëndëve narkotike (më poshtë proceset penale).

18. Më 29 dhjetor 2003, gjykata e rrethit e nxori fajtor ankuesin për krijimin e një organizate kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe e dënoi atë me 19 vjet heqje lirie. Sipas ankuesit, dënimi lidhej me një akuzë të re, për të cilën ai nuk ishte njoftuar kurrë më parë. Më 25 qershor, Gjykata e Apelit të Tiranës (Gjykata e Apelit) la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Por ndryshoi dënimin e ankuesit në 17 vjet heqje lirie. Ankuesi apeloi vendimin në Gjykatën e Lartë. Më 23 qershor 2006, Gjykata e Lartë ndryshoi cilësimin e njërës prej veprave penale për të cilën ishte dënuar ankuesi. Ajo la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ndryshoi dënimin e ankuesit me 15 vjet heqje lirie. Ankuesi i dërgoi një ankesë kushtetuese Gjykatës Kushtetuese kundër vendimeve të lartpërmendura, ankesë e cila është ende pezull në Gjykatën Kushtetuese.

C. Proceset për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata Italiane

1. Kërkesa për vlefshmërinë e vendimit të gjykatave italiane dhe arrestimi i dytë i ankuesit

19. Më 21 shkurt 2002, ndërsa ankuesi ishte i ndaluar për akuzat për pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike (shih paragrafin 12 më lart), zyra e prokurorisë publike të Milanos i kërkoi Ministrisë Italiane të Drejtësisë t'u kërkonte autoriteteve shqiptare të bënin të vlefshëm (të njihnin) në Shqipëri vendimin e dhënë për ankuesin nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) më 2 shkurt 2001, që kishte marrë formë përfundimtare më 30 janar 2002.

20. Më 28 mars 2002, Ministria Italiane e Drejtësisë, ndërmjet të tjerave, e informoi zyrën e prokurorit publik të Milanos se autoritetet italiane nuk mund të kërkojnë njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi penal të dhënë nga gjykata italiane, duke qenë se asnjëri nga shtetet nuk ishte palë në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që lidhej me këtë çështje. Të njëjtën ditë, Ministria Italiane e Drejtësisë, i dërgoi Ambasadës Shqiptare në Romë vendimin e sipërpërmendur për arsye informative.

21. Më 8 prill 2002, Ambasada Shqiptare në Romë, në një letër me kokë çorientuese "Transferimi i një nënshtetasi shqiptar që aktualisht vuan dënimin në Itali", e informoi qeverinë shqiptare për "kërkesën për ekstradim" të Ministrisë Italiane të Drejtësisë për ankuesin, i cili, sipas letrës së ambasadës, "po vuante dënimin në Itali".

22. Më 23 prill 2002, Qeveria e Italisë dhe qeveria e Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, e cila u ratifikua nga parlamentet përkatëse në vitin 2003 dhe 2004.

23. Më 3 maj 2002, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, sipas nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë (KPP), i kërkoi zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të fillonte procedurën për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata italiane për ankuesin.

24. Më 15 maj 2002, gjykata e rrethit, në një proces me një gjyqtar të vetëm, urdhëroi ndalimin e ankuesit në pritje të proceseve për njohjen dhe zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) të datës 2 shkurt 2001 në Shqipëri. Ankuesit iu bë i ditur vendimi, ndërkohë që ishte i ndaluar për proceset penale të përmendura më lart (shih paragrafët 17-18 më lart).

2. Proceset e zakonshme gjyqësore

25. Më 10 maj 2002, sipas nenit 512 dhe 514 të KPP-së, zyra e Prokurorisë së Përgjithshme filloi proceset para gjykatës së rrethit për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të gjykimit të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos (më poshtë "proceset e njohjes dhe zbatimit").

26. Sipas parashtrimeve të ankuesit në gjykatën e rrethit në maj të vitit 2002, neni 514 i KPP-së kërkon, *inter alia*, pëlqimin e tij për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos, pëlqim të cilin ai vendosi të mos e jepte (shih paragrafin 85 më poshtë).

27. Më 13 qershor 2002 Parlamenti miratoi ndryshimet për dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat, *inter alia*, shfuqizuan kërkesën për pëlqimin e të ndaluarit, të parashikuar në pikën (e) të nenit 514 të KPP-së (shih paragrafin 86 më poshtë).

28. Më 17 qershor 2002, Prokurori i Përgjithshëm depozitoi vëzhgime të tjera në gjykatën e rrethit, duke theksuar, ndërmjet të tjerash, se:

"… pavarësisht nga fakti se pëlqimi i personit të dënuar kërkohet nga neni 514 (e) i KPP-së për njohjen në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, kjo duhet të interpretohet vetëm në rrethanat që lidhen me transferimin e personave të dënuar dhe jo në një mënyrë të tillë që të pengojë dhënien e drejtësisë. Për më tepër, Parlamenti, nëpërmjet ligjit nr. 8813 të 13 qershorit 2002, e shfuqizoi pikën (e) të nenit 514 të KPP-së …"

29. Më 20 qershor 2002, gjykata e rrethit e rrëzoi kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, duke e konsideruar atë si jo në përputhje me kërkesat e nenit 514, pika (e) e KPP-së. Gjykata vendosi:

"…kërkesat e parashikuara në nenin 514, pika (e), të KPP-së është e nevojshme për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, në përputhje me Konventën mbi Transferimin e Personave të Dënuar dhe dispozitat e legjislacionit të brendshëm. Në përputhje me formulimin e nenit të sipërpërmendur, kërkohet pëlqimi i personave të dënuar pa dallim ndërmjet rrethanave të transferimit të të ndaluarit ose njohjes së vendimit të dhënë nga një gjykatë e huaj. Për më tepër, ligji nr.8813 i 13 qershorit 2002, që shfuqizon pikën (e) të nenit 514, nuk është i zbatueshëm në rastin në fjalë, pasi ai nuk ka hyrë në fuqi ende …"

30. Më 24 korrik 2002, Gjykata e Apelit rrëzoi ankesën e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjykata pranoi arsyetimin e dhënë në vendimin e gjykatës së rrethit dhe vendosi që ligji nr. 8813 i 13 qershorit 2002 nuk ka efekt prapaveprues me arsyetimin se ai do të çonte në dispozita më të ashpra në dëm të ankuesit.

31. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2002, Prokurori i Përgjithshëm bëri apel në Gjykatën e Lartë (Seksioni penal) kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

32. Më 29 tetor 2002, për unifikimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, Kryetari i Gjykatës së Lartë ia kaloi juridiksionin për çështjen Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

33. Më 30 janar 2003, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, rrëzuan vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të gjykatës së rrethit dhe vendosën t'ia dërgonin çështjen sërish për shqyrtim gjykatës së rrethit. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë i interpretoi dispozitat e KPP-së të lidhura me ekstradimin, transferimin e personave të dënuar dhe njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimeve të dhëna nga gjykata të huaja, duke e dhënë përkufizimin e saj nga pikëpamja e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror. Gjykata vendosi që në rrethanat ku nuk mund të jepej asnjë vendim për një çështje specifike, pasi dispozitat përkatëse ishin të papërshtatshme, baza ligjore mund të ofrohej nga zakonet ndërkombëtare, përkatësisht nga parimet të vullnetit së mirë dhe reciprocitetit dhe traktatet. Në rastin në fjalë, duke thënë se kërkesat e parashikuara në nenin 514, pika (e) të KPP-së ishin të papërshtatshme, ajo ishte e mendimit se Konventa Europiane mbi Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventa Europiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar parashikonte një bazë të mjaftueshme për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos.

34. Gjykata deklaroi, në lidhje me atë çfarë u trajtua më lart, si më poshtë:

"Transferimi i personave të dënuar është rregulluar nga Konventa Europiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar, e ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22 të 1999-ës (…). Konventa Europiane për Njohjen e Vendimeve Penale është e nënshkruar, por nuk është ratifikuar ende nga Parlamenti. Si e tillë, Konventa nuk mund të konsiderohet pjesë përbërëse e korpusit të brendshëm ligjor dhe nuk është drejtpërsëdrejti e zbatueshme. Gjithsesi, nënshkrimi dhe miratimi i dispozitave, sipas të cilave shteti njeh dhe respekton normat dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, na udhëzon të kuptojmë, interpretojmë dhe të zbatojmë drejt dispozitat e KPP-së në fjalë.

(…)

Në rast të njohjes dhe të zbatimit të një vendimi penal të huaj, referenca dhe zgjidhja e çështjes në përputhje me pikën (e) të nenit 514 të KPP-së, në kohën materiale, nuk ka kuptim. Nëse gjykata e konsideron pëlqimin e personit të dënuar si thelbësor, ky pëlqim do të çonte në interpretimin *ad literam* të dispozitës, ashtu siç është zbatuar nga gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit. Por, interpretimi i një dispozite ligjore është shumë kompleks. Në rast se një interpretim ad *literam* çon në absurditet [situatë pa kuptim], mbizotëron interpretimi logjik dhe sistematik. Sipas këtij interpretimi, dispozita në fjalë do të interpretohet në mënyrë të arsyeshme. Kjo do të thotë se nocioni "i pëlqimi të personit të dënuar", nuk mund të interpretohet gjerësisht. Ai duhet të interpretohet ngushtë në mënyrë që të mos çojë në absurditet, siç do të ishte rasti ku ankuesi duhet të japë pëlqimin për të vuajtur dënimin penal në vendin e tij. Siç rrjedh nga aktet, ankuesi është gjykuar *in absentia* pasi i fshihej drejtësisë italiane.

(…)

Pëlqimi i një personi të dënuar nga një gjykatë e huaj është *sine qua non* për caktimin e çështjes, nëse dënimi vuhet në shtetin dënues ose në shtetin e origjinës së personit të ndaluar, çfarë do të thotë në burgjet e vendit të të cilit ai është qytetar [është theksuar më shumë teksti origjinal].

(…)

Ky vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, e zgjidh përfundimisht problemin, sipas së cilit mungesa e pëlqimit të personit të dënuar për njohjen dhe zbatimin e një vendimi të huaj penal nuk është pengesë për gjykatat shqiptare për të vijuar me pranimin dhe njohjen [është theksuar teksti origjinal].

Gjatë shqyrtimit të çështjes, avokati i ankuesit deklaroi se nuk ka marrëveshje dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve penale. Ai tha se një akt i tillë cenon sovranitetin e shtetit shqiptar, i cili ushtrohet nga Parlamenti nëpërmjet ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose dypalëshe. Ky pretendim ishte i pabazuar. Parlamenti shqiptar e manifestoi dëshirën e tij sovrane nëpërmjet miratimit të KPP-së, dispozitat e së cilës duhet të zbatohen në përputhje me kuptimin e tyre dhe me interpretimin e unifikuar të Gjykatë së Lartë, siç theksohet më lart.

Duhet të theksohet se në mungesë të instrumenteve të nënshkruara dhe të ratifikuara, normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare mund të zbatohen në përputhje me parimin e dëshirës së mirë dhe të reciprocitetit. Në përputhje me KPP-në, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, duke përfshirë dhe italianët.

Sipas nenit 512 të KPP-së, është brenda kompetencës së ministrisë përkatëse, si manifestim i dëshirës politike të shtetit shqiptar, të kërkojë njohjen nga gjykata të një vendimi të huaj. Këtë lloj diskrecioni nuk e shqyrton gjykata. Gjykata shqyrton vetëm nëse kërkesa është bërë nga autoriteti kompetent në përputhje me ligjin dhe nëse dokumentacioni është i plotë."

3. Proceset e rigjykimit

35. Në proceset e rigjykimit para gjykatës së rrethit, ankuesi pretendoi se nuk kishte pasur asnjë kërkesë nga autoritetet italiane për njohjen dhe zbatimin e vendimit penal italian kundër tij, duke pasur parasysh dhe letrën e autoriteteve italiane të datës 28 mars 2000 (shih paragrafin 20 më lart). Për më tepër, ai shtoi se nuk kishte marrëveshje dypalëshe ndërmjet të dy shteteve për bërjen efektive të kësaj njohjeje. Ankuesi u bazua gjithashtu në faktin se ai nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për njohjen.

36. Më 20 maj 2003, gjykata e rrethit, me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, u bazua tërësisht në vendimin e Gjykatë së Lartë të 30 janarit 2003. Ajo vendosi se dënimi i dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos ishte në përputhje me dispozitat e KPP-së së Shqipërisë, të ndryshuar nga ligji nr. 8813 i datës 13 qershor 2002. Ajo vendosi që ankuesi të vuante dënimin kumulativ të burgimit të përjetshëm në Shqipëri për vrasje dhe për armëmbajtje pa leje.

37. Gjyqtari drejtues E.K. shprehu një opinion pjesërisht të kundërt për gjykimin e lart-përmendur, duke i kujtuar gjykatës se dispozitat përkatëse statutore parashikojnë një dënim maksimal prej 25 vjet heqje lirie në vend të burgimit të përjetshëm, siç ishte vendosur në çështjen e ankuesit.

38. Sipas parashtrimeve të ankuesit në proceset aktuale përpara gjykatës, gjykata e rrethit zbatoi ato pjesë të ligjit nr.8813 të 13 qershorit 2002 që kontribuan për përkeqësimin e situatës së tij. Për më tepër në përputhje me nenin 13 të KPP-së, siç është ndryshuar në ligjin e lartpërmendur, gjykata, në rastin e tij, duhet të kishte formacionin e gjyqtarit të vetëm. Për më tepër, ai tha se, duke pasur parasysh dhe mendimin ndryshe të gjyqtarit E.K, formacioni i trupit gjykues mund të kishte pasur ndikim mbi rezultatet e proceseve.

39. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2003, ankuesi bëri apel duke përdorur të njëjtën arsyetim kur çështja ishte në gjykatën e rrethit.

40. Më 10 shtator 2003, Gjykata e Apelit rrëzoi ankesën dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke u bazuar tërësisht në gjykimin e Gjykatës së Lartë të 30 janarit 2003.

41. Ankuesi theksoi se në seancën e fundit të proceseve të apelit, gjyqtari Sh. B., i cili kishte qenë drejtues procesi deri në atë moment, ishte zëvendësuar nga gjyqtari D. B., pa vendim zyrtar.

42. Ankuesi i ofroi gjykatës dy vendime të gjykatës së apelit që kishin ekzaktësisht të njëjtin tekst, por ishin dhënë nga dy trupa të ndryshëm gjykues: i pari ishte dhënë nga një trup gjykues i drejtuar nga Sh. B. dhe i dyti nga një trup gjykues i drejtuar nga D. B.

43. Më 9 tetor 2003 ankuesi apeloi në Gjykatën e Lartë. Ai u bazua thuajse në të njëjtat baza apelimi siç kishte bërë kur kishte dërguar çështjen para gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit. Për më tepër, ankuesi e konsideroi zbatimin e normave përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare si të papërshtatshme dhe joprecize.

44. Më 30 janar 2004, Gjykata e Lartë rrëzoi apelin e ankuesit, pasi baza e apelit ishte jashtë objektit të neneve 432 dhe 448 § 2 të KPP-së (shih paragrafët 82 dhe 83 më poshtë).

45. Në prill 2004, ankuesi apeloi në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimeve të Gjykatës së Lartë të datës 30 janar 2003 dhe 30 janar 2004. Ai pretendoi se proceset kishin qenë të padrejta në shumë aspekte. Në veçanti, ai u ankua se proceset penale kishin qenë në kundërshtim me kërkesat e KPP-së të parashikuara në nenin 13 (përbërja e gjykatave), 514 (pëlqimi i personave të dënuar) dhe 512 (njohja dhe zbatimi në Shqipëri të një vendimi të lëshuar nga një gjykatë e huaj, kërkesa që bëhet nga një autoritet i huaj dhe një marrëveshje e vlefshme ndërkombëtare dhe/ose dypalëshe duhej të ishte në fuqi ndërmjet të dyja vendeve). Ankuesi tha se autoritetet italiane nuk kishin bërë asnjë kërkesë për njohje vendimi për Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë, dhe nuk kishte asnjë konventë ndërkombëtare në fuqi ndërmjet të dy vendeve në atë kohë.

46. Më 12 korrik 2004, Gjykata Kushtetuese rrëzoi apelin e ankuesit. Ajo u shpreh se vendimet e Gjykatës së Lartë të datave 30 janar 2003 dhe 30 janar 2004 ishin kushtetuese. Për më tepër, ajo vendosi se megjithëse përbërja e trupit gjykues të gjykatës së rrethit të datës 20 maj 2003 ishte në kundërshtim me ligjin, kjo gjë nuk e bën procesin jokushtetues në tërësi. Në lidhje me praninë e dy gjykimeve të dhëna nga dy trupa të ndryshëm gjykues të gjykatës së apelit të datës 10 shtator 2003, Gjykata Kushtetuese theksoi se kishte vetëm një gjykim në dosjen e çështjes, që i korrespondonte trupit gjykues që kishte vendosur për çështjen.

47. Në vendim, në pjesët përkatëse, thuhej:

"Gjykata Kushtetuese është e mendimit se argumentet e ngritura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [i 30 janarit 2003] nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën ose konventat [ndërkombëtare]. Njohja [vlefshmëria] e ndërsjellë e vendimeve të gjykatës shërben për të forcuar bashkëpunimin juridik ndërmjet shteteve dhe për të arritur objektiva të caktuara në lidhje me lirinë, sigurinë dhe drejtësinë. Parimi i reciprocitetit presupozon përdorimin e instrumenteve të ndërsjella dhe ligjore në marrëdhëniet ndërshtetërore. Në të drejtën ndërkombëtare, reciprociteti përkufizohet si e drejta e barazisë dhe e respektit të ndërsjellë ndërmjet shteteve. Doktrina dhe jurisprudenca ndërkombëtare penale kanë konfirmuar se bashkëpunimi ndërmjet vendeve mund të ndodhë dhe në mungesë të traktateve dypalëshe, mbi bazën e parimi të reciprocitetit.

Si rregull, parimi i reciprocitetit zbatohet në instrumente ndërkombëtare, si në traktate dhe në marrëveshje, që parashikojnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Por, në raste përjashtimore, në mungesë të marrëveshjeve të ndërsjella, shtetet nuk janë të përjashtuara nga zbatimi i drejtpërdrejtë i parimit të reciprocitetit, nga normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare dhe nga vullneti i mirë. Zbatimi i tyre është në interes të forcimit të bashkëpunimit të shteteve për të luftuar krimin e

organizuar dhe kriminalitetin.

Gjykata Kushtetuese thekson se vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, në lidhje me nenet 512 dhe 514 nuk është jokushtetues. Ajo [Gjykata e Lartë] me të drejtë arriti në përfundimin se nuk kishte konflikt ndërmjet këtyre dispozitave dhe ndërmjet dispozitave të konventave ndërkombëtare. Dispozitat e brendshme zbatohen në përputhje me interpretimin e bërë nga Kolegjet e Bashkuara [të Gjykatës së Lartë].

(…) Mund të kuptohet (…) se kërkesa për njohje të një vendimi të një gjykate të huaj mund të bëhet dhe në mungesë të një marrëveshjeje mbi bazën e vullnetit të mirë, normat e njohura gjerësisht dhe parimit të reciprocitetit."

D. Trajtimi mjekësor

48. Më 24 shtator 2003, 13 janar 2004 dhe 16 shkurt 2004, duke marrë shkas nga përkeqësimi i shëndetit të ankuesit, përfaqësuesi i tij ligjor dhe babai i tij i kërkuan Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve të burgut ta lejonin atë të vizitohej nga mjekët e duhur.

49. Nga data 23 gusht 2004 deri më 31 gusht 2004 ankuesi iu nënshtrua trajtimit dhe ekzaminimeve në spitalin e burgut të Tiranës. Gjatë kësaj periudhe atij u bë një skaner me rezonancë magnetike (MRI). Ai u diagnostikua se vuante nga multi skleroza (MS). Mjekët raportuan se, dhe kur sëmundja zbulohet dhe trajtohet menjëherë, ajo ishte në gjendje të shkaktonte gjendje shoku, dëmtim organesh, paaftësi të përhershme ose vdekje.

50. Më 29 shtator 2004 u krye një skaner i dytë me rezonancë magnetike (MRI).

51. Më 5 tetor 2004 përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se gjendja shëndetësore e ankuesit ishte përkeqësuar dhe se, si rrjedhim, nevojitej trajtim i mëtejshëm dhe një vizitë mjekësore e domosdoshme nga specialistë neurologë. Ai depozitoi dy raporte në lidhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit, e cila, sipas mjekëve, ishte përkeqësuar.

52. Më 7 janar 2005, burgu i sigurisë së lartë në Tiranë kërkoi autorizim nga prokuroria e Tiranës për ekzaminime mjekësore në spitalin e burgut të Tiranës për ankuesin dhe për tetë bashkëvuajtës të tij të tjerë në burg.

53. Në një datë të paspecifikuar në janar të 2005-ës, zyra e prokurorisë së Tiranës dha miratimin e saj në lidhje me tetë të burgosurit e tjerë, ndërsa nuk pranoi kërkesën në lidhje me ankuesin, duke thënë se nuk ishte organi kompetent për të vendosur për transferimin e tij nga burgu. Ajo caktoi zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme si autoritetin përkatës për të vendosur.

54. Më 13 janar 2005 burgu i sigurisë së lartë në Tiranë e përsëriti kërkesën e tij për zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me trajtimin mjekësor të ankuesit, por nuk mori përgjigje. Më 17 janar 2005, burgu i kërkoi Njësisë së Përgjithshme të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë të caktonte organin kompetent për të vendosur për transferimin e ankuesit për qëllime mjekësore.

55. Më 16 shkurt 2005, ankuesi filloi proceset penale kundër zyrës së prokurorisë së Tiranës, duke u ankuar për neglizhencë të kësaj të fundit për të siguruar kujdesin e tij mjekësor, gjë e cila kishte çuar në përkeqësimin e shëndetit të tij, që përbënte diskriminim krahasuar me ato të burgosur, të cilët ishin lejuar të përfitonin trajtim mjekësor.

56. Më 26 shkurt 2005, ankuesi u transferua në burgun e Peqinit, një burg i sigurisë së lartë, rreth 100 km larg spitalit të burgut të Tiranës dhe u vendos nën regjimin e burgimit të sigurisë së lartë.

57. Nga shkurti i vitit 2005 e në vijim, ankuesit i ishte mohuar mundësia të takohej me avokatët e tij apo të kishte ndonjë kontakt tjetër me ta.

58. Më 15 prill 2005, pas kërkesave të përsëritura nga mjekët e burgut të Peqinit, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut të Tiranës për trajtim mjekësor. Pas konsultimeve ndërmjet mjekësh të atij spitali dhe të spitalit civil të Tiranës më 19 prill 2005, u konfirmua diagnoza e ankuesit dhe prej tyre u tha se ishte e domosdoshme për shëndetin e tij që të trajtohej me interferon-beta.

59. Në një letër të datës 23 maj 2005, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se prej prillit të vitit 2005 autoritetet e burgut e kishin pezulluar trajtimin mjekësor të ankuesit, në kundërshtim me opinionet e mjekëve, dhe se ai ishte trajtuar me vitamina dhe me medikamente kundër depresionit.

60. Në një letër të datës 28 qershor 2005, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se pa një vendim gjykate ankuesi ishte vendosur nën një regjim të posaçëm burgu, të parashikuar në seksionin 43 të Aktit të Regjimit të të Burgosurve, që ishte përjashtim nga kushtet për burgim të zakonshëm, të parashikuar në Akt.

61. Më 4 nëntor 2005, pas kërkesave të vazhdueshme të ankuesit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e vlerësoi atë dhe raportoi për trajtimin mjekësor që kishte marrë, e gjeti se ai ishte trajtuar kryesisht me medikamente për të kuruar reumatizmën.

62. Në vitin 2005, ankuesi filloi shumë procese penale kundër shefit të spitalit të burgut të Tiranës, duke u ankuar për neglizhencë në dhënien e kujdesit mjekësor për të. Në data të paspecifikuara, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, rrëzoi aplikimin e tij, ndërsa apelet nga ankuesi kundër vendimeve të prokurorit janë ende pezull në gjykatat e brendshme.

63. Nga data 21 deri më 24 shkurt 2006, mjekët konfirmuan se ankuesi vinte nga multi skleroza. Ata raportuan përkeqësim të shëndetit të ankuesit nga mungesa e plotë e trajtimit mjekësor për mbi dy vjet. Të frikësuar për jetën e tij, ata rekomanduan në mënyrë të prerë që ankuesi të merrte trajtimin e duhur mjekësor.

E. Masa të përkohshme të dhëna nga gjykata

64. Në lidhje me kërkesën e ankuesit të datës 3 janar 2008, kryetari i dhomës vendosi, më 10 janar 2008, ta njoftonte qeverinë shqiptare për një masë të përkohshme sipas nenit 39 të rregullores së gjykatës, që thotë: "ankuesi duhet të transferohet menjëherë në një spital civil në mënyrë që të kryhen ekzaminimet e duhura mjekësore mbi situatën e tij, dhe në mënyrë që të marrë trajtimin e nevojshëm për gjendjen e tij." Kryetari vendosi gjithashtu t'i kërkonte qeverisë të informonte menjëherë gjykatën për çdo vendim për të ritransferuar ankuesin në burgun e sigurisë së Lartë të Peqinit, duke bashkëngjitur çdo certifikatë përkatëse mjekësore që mbështeste ritransferimin e tij.

65. Në pasditen e datës 10 janar 2008, duke qenë se ishte hera e parë që zbatohej një masë e përkohshme në lidhje me Shqipërinë, sekretaria e seksionit të katërt (sekretaria), foli me agjenten e qeverisë në telefon dhe e njoftoi zyrtarisht për përmbajtjen e masës së përkohshme dhe për rëndësinë e përmbushjes së saj. Agjentja e qeverisë u informua se një kopje e njoftimit për aplikimin e nenit 39 do t'i dërgohej më pas me faks.

66. Mjaft përpjekje për të dërguar njoftimin me faks ishin të pasuksesshme në mbrëmjen e datës 10 janar 2008. Në mëngjesin e datës 11 janar 2008, duke pasur parasysh problemet e vazhdueshme me dërgimin me faks, iu dërgua një kopje e skanuar e njoftimit me postë elektronike agjentes së qeverisë, e cila konfirmoi marrjen (nëpërmjet postës elektronike) e njoftimit. Të njëjtin mëngjes, agjentja e qeverisë e informoi gjykatën me anë të një bisede telefonike se ajo kishte kontaktuar në mënyrë urgjente me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe me institucione të tjera shtetërore në mënyrë që të përmbushej masa e përkohshme e gjykatës. Në parashtrimet e saj me shkrim, qeveria konfirmoi deklaratën e lartpërmendur.

67. Nga 11 janari deri më 22 janar 2008, qeveria nuk dha asnjë informacion në lidhje me informacionin që kishte të bënte me masat e marra për të zbatuar masën e përkohshme të gjykatës të datës 10 janar 2008.

68. Më 23 janar 2008, ankuesi informoi gjykatën se ai ende nuk ishte transferuar.

69. Më 24 janar 2008, letra e ankuesit iu dërgua qeverisë, duke i tërhequr vëmendje për faktin se mosrespektimi i një mase të ndërmjetme mund të çonte në cenimin e nenit 34 të Konventës.

70. Më 25 janar 2008, pas një vendimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ankuesi u transferua në burgun e spitalit të Tiranës me mendimin e çuarjes në spital për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore. Të njëjtën ditë ankuesi refuzoi të transferohej në spital dhe hyri në grevë urie. Ai pretendonte se autoritetet duhet t'i ofronin atij trajtimin e duhur në vend të kryerjes së ekzaminimeve mjekësore.

71. Më 28 janar 2008, sekretaria i bëri shumë telefonata përfaqësuesit të ankuesit dhe agjentes së qeverisë. Sekretaria i bëri thirrje ankuesit të përfundonte grevën e urisë dhe të respektonte masën e ndërmjetme të gjykatës për transferimin e tij në spital, ku do të kryhej një ekzaminim mjekësor për gjendjen e tij shëndetësore. Sekretaria u bëri thirrje gjithashtu dhe autoriteteve të respektonin masën e ndërmjetme dhe të mos përdornin asnjë lloj force, siç pretendohej nga ankuesi.

72. Në të njëjtën ditë, ankuesi u transferua në pavijonin e neurologjisë të Qendrës Spitalore Universitare, ku iu kryen ekzaminime të specializuara mjekësore.

73. Më 29 janar 2008, pas një letre të Qendrës Universitare Spitalore (QUT), sipas së cilës prania e ankuesit nuk ishte më e nevojshme, ankuesi u transferua sërish në spitalin e burgut të Tiranës.

74. Më 30 janar 2008, qeveria i dërgoi gjykatës një kopje të dosjes mjekësore pas ekzaminimeve mjekësore të datës 28 janar 2008. Një grup mjekësh kishin arritur në përfundimin se ankuesi vuante nga multi skleroza. Grupi i mjekëve rekomandoi që ankuesi të trajtohej me interferon beta për të stabilizuar shëndetin e tij dhe për të parandaluar zhvillimin e sëmundjes. Mjekët nuk ishin në

gjendje të përshkruanin me saktësi zhvillimin e sëmundjes me kalimin e viteve, pasi ankuesi nuk kishte qenë nën kujdesin mjekësor. Ata shprehën mendimin e tyre se shëndeti i ankuesit nuk paraqiste ndonjë urgjencë, dhe, në këto rrethana, pacientët në përgjithësi trajtoheshin jashtë, pa qenë nevoja të shtroheshin në spital.

75. Më 14 korrik 2008, qeveria konfirmoi se trajtimi i ankuesit me interferon beta kishte filluar më 17 qershor 2008 në përputhje me përfundimet e konsultës së mjekëve. Ky trajtim administrohej çdo ditë dhe dukej se shëndeti i ankuesit që prej asaj kohe ishte i qëndrueshëm.

76. Më 16 shtator 2008, kryetari i dhomës vendosi të rrëzonte kërkesën e ankuesit për rizbatimin e nenit 39. Gjithsesi, qeverisë iu kërkua "ta informonte gjykatën rregullisht për gjendjen shëndetësore të ankuesit dhe t'i dërgonte asaj prova mjekësore për gjendjen e ankuesit, duke pasur parasysh se kushtet shëndetësore të ankuesit mund të bënin të nevojshme ndihmë të specializuar mjekësore ndërkohë që ai ishte në burg."

77. Më 12 mars 2009, qeveria e informoi gjykatën se ankuesi ishte pajisur rregullisht me interferon beta dhe me medikamente të tjera të përshtatshme për shëndetin e tij.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

78. Neni 4 §§ 1 dhe 2 i Kushtetutës parashikon se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit dhe se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

79. Neni 5 i Kushtetutës parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

B. Kodi i Procedurës Penale

80. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (KPP) që ishin në fuqi në atë kohë, parashikonin si më poshtë:

1. Neni 13 § 2

81. Neni 13 § 2, pika (ç) i KPP-së, i ndryshuar nga seksioni 1 i ligjit nr. 8813, datë 13 qershor 2002 (në fuqi që prej 11 qershorit 2002), parashikon se "… gjykatat e rrethit mblidhen me formacion me një gjyqtar të vetëm në rastet e bashkëpunimit me autoritetet e huaja…".

2. Nenet 432 dhe 448

82. Neni 432 parashikon se rekurs në Gjykatën e Lartë bëhet për: a) mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të KPP-së; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

83. Neni 448 § 2 parashikon se vendimi i gjykatës së rigjykimit mund të ankimohet vetëm për shkaqet që nuk lidhen me pikat e vendosura nga Gjykata e Lartë.

3. Neni 512

84. Neni 512, për njohjen në Shqipëri të vendimeve të huaja, parashikon se Ministria e Drejtësisë, kur informohet për një vendim të dhënë nga një autoritet i huaj në lidhje me qytetarë shqiptarë, i dërgon zyrës së prokurorisë një kopje të vendimit dhe dokumentet e tjera përkatëse. Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar.

4. Neni 514

85. Neni 514 i Kodit të Procedurës Penale, para se të ndryshohej me ligjin nr. 8813 të datës 13 qershor 2002, parashikonte se vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihej kur:

a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë; b) vendimi përmban dispozita në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar; c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës; ç) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit çështje lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike; d) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar; dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë ose zhvillohet një procedim penal ose e) personi i dënuar ose përfaqësuesi i tij nuk e kanë dhënë pëlqimin e tyre.

86. Seksioni 64 i ligjit nr. 8813, datë 13 qershor 2002 (në fuqi që prej 11 qershorit 2002) parashikon: "Neni 514 § 1, pika e) e KPP-së shfuqizohet."

C. Kodi Penal, ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10 prill 1997, ligji nr. 8279, datë 15 janar 1998 dhe ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001

87. Neni 78 i Kodit Penal që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në vitin 1997, parashikonte se një person i dënuar për vrasje me paramendim dënohet me pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet heqje lirie, dhe, në rast të rrethanave rënduese, me burgim të përjetshëm ose me vdekje.

88. Duke marrë parasysh rigjallërimin e hakmarrjeve në rajonet veriore dhe verilindore të Shqipërisë, ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001, që hyri në fuqi më 13 mars 2001, ndryshoi, *inter alia*, dhe nenin 78 të Kodit Penal duke shtuar një paragraf të ri që rregullon vrasjet për hakmarrje në mënyrë që të ndalohej shkatërrimi i plotë i familjeve. Dispozita e re, në fuqi në kohën kur vendimi italian u konvertua nga gjykatat shqiptare, lexon si më poshtë:

Neni 78

"1. Një person i dënuar për vrasje me paramendim dënohet me pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet heqje lirie.

2. Një person i dënuar për vrasje me paramendim për shkak të një interesi ose/dhe hakmarrjes dënohet nga njëzet vjet burgim deri me burgim të përjetshëm."

D. Akti për të Drejtat dhe Trajtimin e të Burgosurve (Ligji nr. 8328, datë 16 prill 1998, ndryshuar me ligjin nr. 9888, datë 10 mars 2008 – "Akti i të Drejtave të të Burgosurve")

89. Seksioni 33 i Aktit të të Drejtave të Burgosurve, në fuqi në kohën në fjalë, parashikon se, në mungesë të trajtimit mjekësor në njësinë shëndetësore të spitalit, dhe, kur është e nevojshme, i burgosuri transferohet në një spital burgu ose në një institucion tjetër mjekësor, me urdhër të prokurorit. I burgosura ka të drejtë të ankimojë brenda pesë ditësh në gjykatën e rrethit kundër refuzimit të prokurorit [për ta transferuar atë në spital].

III. MATERIALET NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE

A. Konventa Ndërkombëtare për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Seritë e Traktatit Europian (ETS) nr. 70)

90. Konventa ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 23 janar të vitit 2004. Ajo u nënshkruan nga Italia me 4 shkurt të vitit 1971, dhe as sot e kësaj dite nuk është ratifikuar. Pra, ajo nuk ishte në fuqi në lidhje me vendin tjetër më 20 maj 2003, kur ankuesi u dënua nga Gjykata e Rrethit të Tiranës. Dispozitat përkatëse të saj parashikojnë si më poshtë:

Neni 3

"1. Një Shtet Kontraktues është kompetent në rastet dhe në kushtet e parashikuara në këtë Konventë për të zbatuar një vendim të dhënë në një tjetër Shtet Kontraktues që është i zbatueshme në këtë shtet.

2. Kjo kompetencë mund të ushtrohet pas një kërkese nga Shteti tjetër Kontraktues."

B. Konventa për Transferimin e Personave të Dënuar (ETS nr. 112) dhe Protokolli Shtesë i saj (ETS nr. 167)

91. Objektivat e Konventës së Transferimit të vitit 1983, duke përfshirë dhe Protokollin e saj Shtesë të vitit 1997, janë që të zhvillohet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale dhe të çohen më tej qëllimet e drejtësisë dhe të rehabilitimit shoqëror të personave të dënuar. Preambula e Konventës së Transferimit thotë se objektivat kërkojnë që të huajt, të cilëve u është mohuar liria si rezultat i kryerjes së një vepre penale prej tyre, duhet t'u jepet e drejta të vuajnë dënimin e tyre brenda shoqërisë së tyre. Dispozitat e saj, të lidhura me çështjen, parashikojnë si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

"Në kuptimin e kësaj Konvente:

(…)

c. "Shteti dënues" është shtetit në të cilin është marrë vendimi për personin që mund të transferohet ose është transferuar;

d. "Shteti administrues" është shteti tek i cili personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar në mënyrë që të vuajë dënimin".

Neni 3

Kushtet e transferimit

"1. Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj Konvente, vetëm në kushtet e mëposhtme:

a. nëse ky person është nënshtetas i shtetit administrues;

(…)"

92. Konventa e Transferimit ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 gusht 2000, dhe në Itali më 1 tetor 1989. Protokolli i saj Shtesë nuk është ratifikuar as sot e kësaj dite nga asnjë nga shtetet.

C. Raportet e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues ("CPT-ja")

93. CPT-ja ka vizituar Shqipërinë në vitin 2005, 2006 dhe 2008. Në 2005-ën, delegacioni vizitoi, inter alia, dhe spitalin e burgut të Tiranës.

1. Gjetjet përkatëse të raportit të 2005-ës (të bëra publike në 12 korrik 2006)

94. Në këtë raport (CPT/Inf (2006) 24) CPT-ja identifikoi se ambientet e kujdesit shëndetësor, "ishin të një cilësie shumë të varfër në të gjitha qendrat e vizituara. Për shembull, kudo mungonte dhe një pajisje bazë, si peshoret. Megjithëse është e panevojshme të thuhet, një gjendje e tillë pune pengon edhe kontrollin e përshtatshëm të ushqimit të ofruar në burg, dhe mbikëqyrjen e grevave të urisë që ndodhnin herë pas here. Është gjithashtu shqetësuese që në dhomën e kirurgjisë dentare në burgun e Tiranës-Vaqarr, nuk kishte ujë. Më tej, si në burgun e Tepelenës dhe në burgun 313 të Tiranës, gjendja e pastërtisë dhe e higjienës në dhomat e konsultimit të mjekëve linte shumë për të dëshiruar."

95. CPT-ja vë re më tej "disa mangësi serioze në lidhje me kontrollin mjekësor në pranim të të burgosurve në burgjet e vizituara (në veçanti, ekzaminime që nuk kryheshin në mënyrë sistematike ose që kryheshin vetëm sa për të kaluar radhën)." Ajo shpreh gjithashtu shqetësimin e saj se "personat e ardhur rishtazi në pritje të dënimit, nuk kontrolloheshin në mënyrë sistematike për sëmundje të transmetueshme (të tilla si hepatiti B dhe C, HIV, sifilizi dhe turbekulozi), dhe se të burgosurve nuk u jepej asnjë informacion në lidhje me parandalimin e këtyre sëmundjeve".

96. CPT-ja vuri re se në burgjet nr. 302 dhe 313 disa nga dosjet mjekësore nuk ekzistonin. Dhe kur "gjendeshin", dosjet nuk përmbanin asgjë përveç emrave të të dënuarve përkatës.

97. Në lidhje me trajtimin e pacientëve me kushte serioze mjekësore, CPT-ja vuri re një numër rastesh individuale që ilustronin mangësi alarmante në disa prej qendrave të vizituara. Fragmentet përkatëse deklarojnë:

"Në burgun e Tepelenës dhe të Tiranës, në Vaqarr, delegacioni u takua me dy të burgosur, të cilët, si rezultat i gjendjes së tyre shëndetësore (njëri me psikozë të rëndë dhe tjetri në gjendje të avancuar kanceri), kishin nevojë urgjente për trajtim të specializuar në ambiente spitalore. Gjithsesi, nuk ishte marrë asnjë iniciativë për t'i transferuar të burgosurit në spitalin përkatës të burgut. Gjatë bisedave në fund të vizitës, delegacioni u kërkoi autoriteteve shqiptare të merrnin masa urgjente në lidhje me këto dy raste. Në letrën e tyre të datës 14 korrik 2005, autoritetet shqiptare konfirmuan se të dy të burgosurit ishin transferuar në spitalin e burgut.

Në burgun e Vaqarrit në Tiranë, delegacioni u takua me një të burgosur që vuante nga diabeti, i cili nuk merrte një dietë të veçantë. CPT-ja duhet të theksojë se një nivel i tillë pune çon në mohimin e trajtimit. Më tej, në rastin e një të burgosuri tjetër në Vaqarr, Tiranë, i cili vuante nga tuberkulozi, delegacioni vuri re se kishte pasur një vonesë të konsiderueshme në transferimin e të burgosurit përkatës në spitalin e burgut. Më tej, gjatë transferimit të tij në spital nuk ishte marrë asnjë masë mbrojtëse në mënyrë që të shmangej infektimi i të burgosurve ose i të dënuarve të tjerë nga sëmundja."

98. CPT-ja u rekomandoi autoriteteve shqiptare të rishikonin dispozitat e kujdesit shëndetësor në qendrat e vizituara prej tyre.

2. Gjetjet përkatëse në raportin e 2006-ës (të bëra publike më 6 shtator 2007)

99. Në këtë raport (CPT/Inf (2007) 35) të CPT-së u theksua mosrespektimi nga ana e autoriteteve vendore i rekomandimeve të tyre, në veçanti në lidhje me ekzaminimet mjekësore në pranimet në qendrat e paraburgimit.

100. CPT-ja vuri re se "nuk janë bërë përmirësime në lidhje me dispozitën e përgjithshme të kujdesit shëndetësor në asnjë nga ambientet e vizituara, pavarësisht nga rekomandimet e ndryshme të bëra nga CPT-ja në raportet e saj pas vizitave të 2003-it dhe të 2005-ës".

101. Në lidhje me një ndër ambientet e paraburgimit të vizituar nga CPT-ja, ajo vuri re se "kushtet në ambientet e kujdesit shëndetësor ishin alarmante. Delegacioni dëgjoi shumë ankesa nga të burgosurit rreth vonesave për t'u vizituar nga doktori dhe rreth cilësisë së kujdesit shëndetësor të ofruar; vetë delegacioni, qe dëshmitar i një të burgosuri që kishte nevojë për ndihmë mjekësore urgjente i cili ishte lënë në një gjendje neglizhence të plotë".

102. CPT-ja ngriti çështjen e vonesave të gjata të vëna re në transferimin e të burgosurve që kishin nevojë urgjente të shtroheshin në spital. "Vizita e vitit 2006 demonstroi se ky problem nuk ishte zgjidhur ende. Delegacioni u informua se spitalet e përgjithshme ngurronin të pranonin të dënuar në

qendrat e paraburgimit për shkak të arsyeve të sigurisë, ndërsa transferimi në spitalin e burgut të Tiranës raportohej si i vështirë pasi spitali i burgut është nën kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë".

Gjetjet përkatëse në raportin e 2008-ës (të bëra publike më 21 janar 2009)

103. Në këtë raport (CPT/Inf (2009) 6) CPT-ja evidenton se ofrimi i kujdesit të përgjithshëm shëndetësor në tërësi duket i përshtatshëm në pjesën më të madhe të qendrave të vizituara, pavarësisht nga situatat që çonin në shqetësime të caktuara. Ai vuri re dhe disa përmirësime në lidhje me ekzaminimet shëndetësore në pranim, megjithëse kjo "mbetet një fushë veçanërisht problematike në sistemin e burgjeve në Shqipëri".

104. CPT-ja deklaroi se kishte pasur mangësi në ofrimin e kujdesit të specializuar shëndetësor, në veçanti në ofrimin e kujdesit dentar dhe të kujdesit psikiatrik.

LIGJI

I. CENIM I PRETENDUAR i nenit 3 TË KONVENTËS

105. Ankuesi u ankua për mungesë të trajtimit të duhur mjekësor në burg që çon në keqtrajtim, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese."

A. Pranueshmëria

106. Qeveria e kontestoi argumentin e ankuesit. Ajo parashtroi se ankuesi kishte marrë të gjithë trajtimin e nevojshme në spitalin e burgut dhe u ishte nënshtruar disa ekzaminimeve mjekësore. Gjithsesi, ajo tha se përderisa ankuesi nuk e ka ngritur çështjen në gjykatën e brendshme kompetente, në përputhje me Aktin e të Drejtave të të Burgosurve, ankesa e tij në lidhje me nenin 3 ishte e papranueshme për mos shterim të burimeve të brendshme.

107. Ankuesi vijoi me pretendimet e tij. Ai parashtroi se ndihma mjekësore e marrë në spitalin e burgut ishte e papërshtatshme. Autoritetet ishin plotësisht të ndërgjegjshme për sëmundjet e tij (shih paragrafët 52 dhe 58 më lart). Babai i tij kishte pyetur për shëndetin e të birit në disa raste. Por, të gjitha përgjigjet e marra nga administrata e burgjeve kishin qenë të një natyre të përgjithshme dhe nuk kishin përfshirë asnjë informacion të detajuar në lidhje me trajtimin e marrë prej tij. Ankuesi theksoi në veçanti faktin se autoritetet e burgjeve e kishin trajtuar atë me medikamente jo të duhura, duke i shkaktuar atij dhimbje dhe duke e përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore. Së fundmi, ankuesi pretendoi se qeveria kishte dështuar në të provuarin e përshtatshmërisë së masave që kërkoheshin të merreshin, pasi të gjitha ankesat e tij kundër mjekëve të spitalit të burgut ishin rrëzuar nga prokurori si të pabaza.

108. Gjykata përsërit se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike i detyron ata që kërkojnë të ngrenë çështjen e tyre kundër një shteti në një organ ndërkombëtar gjyqësor ose arbitrazhi të përdorin së pari mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar. Rregulli bazohet në supozimin se ka mjete efektive të disponueshme në lidhje me shkeljen e pretenduar në sistemin e brendshme, pavarësisht nëse dispozitat e Konventës janë ose jo të inkorporuara në të drejtën e brendshme. Në këtë mënyrë, ky është një aspekt i rëndësishëm i parimit që makineria e mbrojtjes e parashikuar në Konventë është plotësuese për sistemet kombëtare që ruajnë të drejtat e njeriut (shih Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, Seritë A nr. 24). Në të njëjtën kohë, është detyrim i qeverisë të ofrojë një mjet efektiv të disponueshëm në teori dhe në praktikë për gjykatën në kohën në fjalë, pra një mjet që ishte i akesuseshëm, i aftë për të trajtuar pretendimet e ankuesit dhe që ofron mundësi të arsyeshme suksesi (shih Selmouni k. Francës [GC], nr. 25803/94, § 76, ECHR 1999-V, dhe Mifsud k. Francës (vend.), nr. 57220/00, § 15, ECHR 2002-VIII).

109. Gjykata vëren se ankuesi ka depozituar shumë ankesa tek autoritetet përgjegjëse, duke i sjellë shqetësimet e tij në vëmendje të autoriteteve kombëtare në një kohë që pritej në mënyrë të arsyeshme që ata të kishin marrë masat e nevojshme. Përshkrimi i problemeve shëndetësore nga ankuesi në ankesat e tij ishte i detajuar dhe koherent. Autoritetet kishin një dosje të historisë së tij mjekësore dhe ishin të informuara për rekomandimet e bëra nga mjekët civilë në lidhje me trajtimin mjekësor të nevojitur. Gjithsesi, ankesat u rrëzuan të gjitha nga prokurori, si të pabazuara.

110. Gjykata vë re se qeveria ka dështuar në të provuarin se mjetet e ofruara do të kishin qenë praktikisht efektive. Ajo nuk dorëzoi asnjë vendim të asnjë gjykatë të brendshme për të mbështetur pozicionin e saj. Nuk ka prova se një mjet i tillë do të kishte qenë i aftë të trajtonte pretendimin e ankuesit dhe të ofronte perspektiva të suksesshme suksesi. Si rezultat, gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë.

111. Duke pasur parasysh konsideratat e sipërpërmendura, gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata vë re më tej, se ajo nuk është e papranueshme për asnjë arsye tjetër. Si rezultat, ankesa duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

112. Ankuesi pretendon se autoritetet nuk i kanë dhënë trajtimin mjekësor të kërkuar prej tij, sipas mendimit dhe recetave të mjekëve civilë, duke çuar në keqtrajtim. Ai u bazua në raportet mjekësore për gjendjen e tij shëndetësore, dhe në veçanti në raportet mjekësore të datës 19 prill 2005 dhe 12 dhjetor 2006, që theksojnë mungesën e trajtimit mjekësor të marrë nga ankuesi për një periudhë të zgjatur kohore dhe ndikimet e kësaj gjëje mbi përkeqësimin e shëndetit të tij.

113. Qeveria insistoi se ankuesi kishte marrë trajtimin e saktë dhe të duhur mjekësor. Në parashtrimet e saj, tregohet se nga koha e arrestimit në vitin 2001 e në vijim se ankuesi kishte marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut të Tiranës nëntë herë, ku i ishte ofruar trajtimi dhe ekzaminimet e duhura mjekësore. Qeveria përfundoi se pretendimi i ankuesit sipas nenit 3 ishte i pabazuar.

114. Pas njoftimit të Gjykatës për masë të përkohshme sipas nenit 39 të rregullores së gjykatës, qeveria parashtroi se dhënia e interferon beta për ankuesin kishte një kosto shumë të lartë për administratën e burgjeve. Por, gjithsesi, Qeveria pranoi se ky mjekim është i disponueshëm pa pagesë për publikun e përgjithshëm në spitale.

2. Vlerësimi i gjykatës

115. Gjykata vë re se palët paraqitën të dhëna të ndryshme në lidhje me ndihmën mjekësore të marrë nga ankuesi në burg. Si rrjedhim, gjykata do të fillojë ekzaminimin e saj për pretendimet e ankuesit në lidhje me nenin 3 me kërkimin e fakteve përkatëse.

a) Përcaktimi i fakteve

116. Në çështjen në fjalë, ankuesi pretendon se ai nuk ka marrë trajtimin ose ekzaminimin e duhur mjekësor, në përputhje me gjendjen e tij, ndërkohë që ishte i ndaluar.

117. Nuk diskutohet nga palët që pas arrestimit të tij në vitin 2001 e deri në gusht të 2004-ës ankuesi ka marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut për simptoma dhe sindroma të ndryshme. Pavarësisht nga mosha e tij e re, ankuesi vuante, përveç të tjerash, nga vështirësi në lëvizje dhe dhimbje të fortë në ekstremitetet e poshtme, probleme në urinim dhe kapsllëku. Vetëm në gusht të 2004-ës, pas një ekzaminimi të hollësishëm, ankuesi u diagnostikua se vuante nga multiskleroza (shih paragrafin 49 më lart).

118. Nga janari deri në shtator 2005, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut për trajtim dhe ekzaminime vetëm në një rast, pavarësisht nga kërkesat e tij të përsëritura. Kështu, më 19 prill 2005, një grup mjekësh e vizituan, konfirmuan diagnozën e multisklerozës dhe i dhanë trajtim të vazhdueshëm me interferon-beta në përputhje me protokollet mjekësore (shih paragrafin 58 më lart).

119. Gjykata vë re, me shqetësim, se gjatë ndalimit të tij nga prilli i vitit 2005 deri më 28 janar 2008, data në të cilën ankuesi i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor si rezultat i marrjes së masës së përkohshme nga gjykata për qeverinë përkatëse, ankuesi ishte lënë për periudha të gjata kohore pa trajtimin e duhur mjekësor. Raporti i fundit mjekësor për gjendjen shëndetësore të ankuesit konfirmoi se zhvillimi i sëmundjes me kalimin e viteve ishte si rezultat i mungesës së kujdesit mjekësor (shih paragrafin 74 më lart).

120. Në të paktën dy raste, babai i ankuesit i ka kërkuar administratës së burgut një kontroll të pavarur mjekësor të shëndetit të ankuesit dhe trajtim të duhur mjekësor për të (shih paragrafin 48 më lart). Gjithsesi, këto kërkesa u refuzuan: siç del nga certifikata mjekësore e dhënë nga qeveria, ekzaminimet mjekësore të mëparshme për ankuesin ishin të munduara vetëm pas miratimit të prokurorit. Është alarmuese që çështja e ekzaminimit mjekësor të ankuesit i është lënë për të vendosur prokurorit, jo mjekëve, nëse ankuesi kishte nevojë për ekzaminime të tjera mjekësore.

121. Në përmbledhje, faktorët e sipërpërmendur duken se mbështesin pretendimet e ankuesit se kujdesi i tij mjekësor në burg ishte i papërshtatshëm. Në rrethana të tilla, i takon qeverisë të kundërshtojë këtë gjetje. Gjithsesi, qeveria nuk ofroi asnjë dokument për të justifikuar arsyet pse autoritetet refuzuan t'i jepnin ankuesit trajtimin mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, ose të shpjegojë si trajtimi me vitamina dhe antidepresantë mund të konsiderohet i përshtatshëm (shih paragrafin 59 më lart), (shih, mutatis mutandis, Ostrovar k. Moldavisë, nr. 35207/03, § 86, 13 shtator 2005). Qeveria, thjesht, dhe shumë sipërfaqësisht, pretendon, pa shpjeguar ose pa ofruar argumente të mëtejshme, se ankuesi i është

nënshtruar “trajtimit spitalor disa herë në ambientet e spitalit të burgut”. Si rezultat, gjykata është e mendimit se qeveria nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm për përkeqësimin e shëndetit të ankuesit në burg.

122. Si rezultat, gjykata e pranon versionin e ankuesit për problemet e tij shëndetësore dhe ndihmën mjekësore të marrë gjatë burgimit. Në veçanti, gjykata pranon se nga tetori i vitit 2004 e deri në prill 2005, ankuesit i është refuzuar marrja e ekzaminimit mjekësor dhe trajtimi në spitalin e burgut, dhe se trajtimi mjekësor i dhënë në burg nuk ishte në përputhje me kushtet e tij shëndetësore. Gjatë të gjithë ndalimit të tij nga tetori i vitit 2004 e në vijim, autoritetet dështuan në monitorimin e sëmundjes së tij dhe ofrimin e trajtimit të duhur mjekësor, gjë që përkeqësuan kushtet e tij shëndetësore. Nga maji i vitit 2005 deri në 28 janar të vitit 2008, ankuesi u konsiderua se nuk kishte nevojë për trajtim mjekësor shtesë, pavarësisht nga raportet e mjekëve civilë për të. Vetëm më 17 qershor 2008 ankuesit iu ofrua trajtimi i nevojshëm, si rezultat i ekzaminimeve mjekësore të 28 janarit 2008.

123. Gjykata tani do të shqyrtojë nëse këto fakte, të marra së bashku me rrethanat përkatëse të çështjes, çojnë në “trajtim çnjerëzor dhe degradues”, siç sugjerohet nga ankuesi.

b) Shqyrtimi i ankesës

124. Gjykata thekson se neni 3 i Konventës flet për një ndër vlerat më themelore të një shoqërie demokratike. Ai ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin ose dënimin çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih Labita k. Italisë, nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV).

125. Gjykata thekson më tej se, sipas jurisprudencës së saj, keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal ashpërsie për t’u konsideruar se bien në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ky minimum varet nga tërësia e rrethanave të çështjes, efektet e saj fizike dhe mendore, dhe, në disa raste, seksi, mosha, gjendja shëndetësore e viktimës (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Ireland k. Mbretërisë së Madhe, vendim i 18 janarit 1978, Seritë A nr. 25, f. 65, § 162). Megjithëse qëllimi i një trajtimi të tillë është faktor për t’u marrë parasysh, në veçanti pyetja nëse ai kishte si qëllim të poshtëronte ose të degradonte viktimën, mungesa e një qëllimi të tillë nuk të çon në mënyrë të paevitueshme në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 (shih Peers k. Greqisë, nr. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III).

126. Në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit është absolutisht e papërputhshme me burgimin, neni 3 mund të kërkojë nxjerrjen e një personi të tillë në kushte të caktuara (shih Papon k. Francës (nr. 1) (dec.), nr. 64666/01, ECHR 2001-VI, dhe Priebke k. Italisë (vend.), nr. 48799/99, 5 prill 2001). Ka tre elemente të veçanta që duhen shqyrtuar në lidhje me përputhshmërinë e shëndetit të ankuesit me qëndrimin e tij në burgim: (a) kushtet mjekësore të të burgosurit, (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim; dhe (c) kështillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të ankuesit (shih Mouisel k. Francës, nr. 67263/01, §§ 40-42, ECHR 2002-IX).

127. Gjithsesi, neni 3 nuk mund të interpretohet sikur parashikon një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të burgosurve për arsye shëndetësore. Ai, në fakt i vendos detyrimin shtetit të mbrojë mirëqenien fizike të personave të cilëve u është mohuar liria. Gjykata e pranon se ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut jo gjithmonë mund të jetë në të njëjtin nivel si ndihma e ofruar në institucionet më të mira mjekësore për publikun e gjerë. Gjithsesi, shteti duhet të sigurojë se ruhen siç duhet shëndeti dhe mirëqenia e të burgosurve nëpërmjet, ndër të tjerash, ofrimit të ndihmës së nevojshme mjekësore (shih Kudła k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 94, ECHR 2000-XI; shih gjithashtu Hurtado k. Zvicrës, vendimi i 28 janarit 1994, Seritë A nr. 280-A, opinion i Komisionit, faqe. 15-16, § 79; dhe Kalashnikov k. Rusisë, nr. 47095/99, §§ 95 dhe 100, ECHR 2002-VI). Në Farbtuhs k. Letonisë (nr. 4672/02, § 56, 2 dhjetor 2004). Gjykata theksoi se nëse autoritetet do të kishin vendosur të çonin dhe të mbanin një person të sëmurë rëndë në burg, ata duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për garantimin e kushteve të burgimit që u përkojnë nevojave të veçanta të të burgosurit që vijnë si rezultat i paaftësisë së tij (shih gjithashtu Paladi k. Moldavisë, nr. 39806/05, § 81, 10 korrik 2007).

128. Gjykata mban parasysh raportet e CPT-së, të cilat, ndonëse nuk përmbajnë informacion që lidhet drejtpërsëdrejti me kushtet aktuale të ndalimit të ankuesit dhe gjendjes së tij shëndetësore, gjithsesi e informojnë gjykatën duke i ofruar një panoramë të plotë të situatës së përgjithshme në burgjet në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë (shih, për shembull, I.I. k. Bullgarisë, nr. 44082/98, § 71, 9 qershor 2005).

129. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, gjykata vë re se provat nga burimet e ndryshme mjekësore konfirmojnë se ankuesi kishte probleme të shumta mjekësore që kërkonin ndihmë të rregullt mjekësore. Gjithsesi, asgjë nuk sugjeronte se sëmundjet e tij ishin në parim të papërputhshme me burgimin. Burgu kishte një njësi mjekësore, ku ankuesi ishte vizituar në shumë raste, dhe sëmundja e tij prezumohet të mund të ishte trajtuar në atë njësi.

130. Në të njëjtën kohë, gjykata i referohet vëzhgimeve të saj se ankuesi nuk e kishte marrë ndihmën e nevojshme ligjore (shih paragrafët 121 dhe 122 më lart). Edhe ndërsa ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve të tij mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, ai mund të ketë ditur se ishte në rrezik të një emergjence mjekësore në çdo moment, emergjencë me pasoja serioze dhe se nuk kishte ndihmë të kualifikuar mjekësore të disponueshme. Ankuesit jo vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga autoritetet, por ai u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, duke iu mohuar mundësia për të kontaktuar me përfaqësuesin e tij (shih paragrafin 56 dhe 57 më lart). Kjo mund të ketë çuar në një ankth të konsiderueshëm në anën e tij.

131. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e qeverisë se trajtimi i ankuesit me interferon beta do të ngarkonte rëndë Buxhetin e Shtetit. Ndërsa gjykata nuk nënvlerëson vështirësitë financiare të qeverisë, ajo thekson se ky medikament ofrohet pa pagesë për publikun në spitale. Qeveria nuk dha asnjë arsye legjitime për të justifikuar heqjen e së drejtës së ankuesit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të publikut, për t'iu përmbushur kostot e medikamenteve të tij plotësisht nga shteti përkatës të.

132. Ankuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, nga multiskleroza. Edhe nëse zbulohet dhe trajtohet shpejt, kjo sëmundje është e aftë të shkaktojë paaftësi (njohëse, gjykuese, dhe çrregullime kujtese, probleme në lëvizje, dhimbje, kushte të varfra dhe mosfunksionim të muskujve unazorë) dhe vdekje. Rreziku i sëmundjes, i shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatja e kohës së burgimit, e intensifikuan frikën e tij. Në këto rrethana, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e nenit 3.

133. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 5 § 1 TË KONVENTËS

134. Ankuesi pretendon se burgimi i tij nga data 30 prill 2001 e në vijim ka qenë i paligjshëm dhe se autoritetet nuk kanë mundur të justifikojnë arrestimin dhe ndalimin pasues të tij sipas ndonjërës nga arsyet specifike të parashikuara në nenin 5 § 1 dhe se kjo ishte pasojë e proceseve arbitrare.

135. Gjykata është e mendimit se pretendimi i ankuesit duhet të shqyrtohet sipas nenit 5 § 1 (a) dhe (c) të Konventës, e cila, në pjesët përkatëse, parashikon:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar

a. kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

…"

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

136. Qeveria pretendoi se arrestimi dhe ndalimi i ankuesit ishin bërë në përputhje me dispozitat e nenit 5 § 1 të Konventës. Qeveria nuk ka parashtruar asnjë kundërshtim në lidhje me pranueshmërinë e kësaj ankese.

137. Ankuesi kontestoi argumentin e qeverisë.

2. Vlerësimi i gjykatës

138. Gjykata vë re se ankuesi u ndalua fillimisht më 30 prill 2001 me fuqinë e padisë penale që lidhej me përfshirjen e tij të pretenduar në trafikim droge. Del nga kërkesat e palëve se thelbi i vëzhgimeve të tyre ka lidhje me ndalimin e ankuesit që prej 15 majit 2002 për sa i përket proceseve që kanë të bëjnë me njohjen dhe me zbatimin e gjykimit të Gjykatës Italiane.

139. Mbi këtë kuptim, gjykata do të shqyrtojë ligjshmërinë e ndalimit të ankuesit nga data 15 maj 2002. Gjykata është e mendimit se datë përfundimtare do të jetë 29 dhjetori 2003, data në të cilën ankuesi ishte dënuar për trafikim droge në grupin e parë të proceseve. Pas asaj date, kishte një bazë

ligjore për ndalimin e tij sipas nenit 5 § 1 (a) të Konventës.

140. Për më tepër, Gjykata është e përgatitur të trajtojë ndalimin e ankuesit që prej 15 maj të 2002-it sikur të bjerë nën objektin e nenit 5 § 1 (a) të Konventës. Për gjykatën, në lidhje me proceset që lidhen me njohjen e vlefshmërisë dhe zbatimit të vendimeve të lëshuara nga një gjykatë e huaj, prezumimi është që ndalimi i një individi është "ndalimi i ligjshëm … pas dënimit nga një gjykatë kompetente".

141. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e keqbazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vë re më tej se ankesa nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Si rezultat, gjykata e deklaron ankesën të pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

142. Qeveria pretendoi se ndalimi i ankuesit është në përputhje me nenin 5 § 1 të Konventës. Ajo parashtroi se më 15 maj 2002, autoritetet kishin urdhëruar ndalimin e tij në burg, pavarësisht nga fakti se ai mbahej në mënyrë strikte në ruajtje mbi bazën e një tjetër grupi procesesh kundër tij. Ndalimi ishte bazuar në dispozitat përkatëse të brendshme, siç interpretohet nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të datës 30 janar 2003. Si rezultat, ajo ka përmbushur gjithashtu dhe kërkesat e nenit 5.

143. Ankuesi i kontestoi argumentet e qeverisë.

144. Për sa i përket referencës së bazës ligjore për ndalimin e tij, ankuesi theksoi se, sipas parashtrimeve të qeverisë, ndalimi ishte bazuar në dispozitat e përgjithshme të Konventës Europiane mbi Transferimin e Proceseve në Çështjet Penale, megjithëse Konventa nuk ishte ratifikuar nga Shqipëria në kohën në fjalë, ndërsa, sipas vendimeve të gjykatës, ndalimi i tij ishte bazuar në dispozitat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Si rezultat, asnjë nga dispozitat e lart-përmendura nuk mund të konsiderohet se plotëson kërkesën e "ligjshmërisë" që kërkohet nga neni 5 § 1 i Konventës. Së fundi, ankuesi pretendon se ndalimi i tij ishte i paligjshëm, pasi ai nuk ishte bazuar në asnjë dispozitë ligjore në fuqi në kohën në fjalë dhe ishte pasojë e proceseve arbitrare.

145. Ai iu referua jurisprudencës së Gjykatës dhe në veçanti vendimit në çështjen Bozano (Bozano k. Francës, vendim i datës 18 dhjetor 1986, Seritë A nr. 111, f. 25-26, §§ 58-59).

2. Vlerësimi i gjykatës

(a) Parimet e përgjithshme

146. Neni 5 i Konventës garanton të drejtën themelore të lirisë dhe të sigurisë. Kjo e drejtë ka një rëndësi thelbësore në një "shoqëri demokratike" brenda kuptimit të Konventës (shih De Wilde, Ooms dhe Versyp k. Belgjikës, vendimi i datës 18 qershor 1971, Seritë A nr. 12, f. 36, § 65 dhe Winterwerp k. Holandës, vendimi i datës 24 tetor 1979, Seritë A nr. 33, f. 16, § 37).

147. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtjen e kësaj të drejte, çfarëdo të thotë, të mos u mohohet, ose të vazhdohet t'u mohohet, liria e tyre (shih Weeks k. Mbretërisë së Madhe, vendim i datës 2 mars 1987, Seritë A nr. 114, f. 22, § 40), dhe në përputhje me kushtet e specifikuara në paragrafin 1 të nenit 5. Lista e përjashtimeve të parashikuara në nenin 5 § 1 është shteruese (shih Labita k. Italisë [GC], nr. 26772/95, § 170, ECHR 2000-IV, dhe Quinn k. Francës, vendim i datës 22 mars 1995, Seritë A nr. 311, f. 17, § 42) dhe vetëm një interpretim i ngushtë i këtyre përjashtimeve është në përputhje me qëllimin e kësaj dispozite, përkatësisht për t'u siguruar se askujt nuk i mohohet në mënyrë arbitrare liria e tij ose e saj (shih Engel dhe të tjerët k. Holandës, vendim i datës 8 qershor 1976, Seritë A nr. 22, f. 25, § 58, dhe Amuur k. Francës, vendim i datës 25 qershor 1996, Reportet 1996-III, f. 848, § 42).

148. Gjykata përsëriti se "kur bëhet fjalë për mohim të lirisë, është në veçanti e rëndësishme të plotësohet parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore. Pra, si rezultat, është shumë e rëndësishme që të përcaktohen qartë kushtet e mohimit të lirisë në të drejtën e brendshme dhe që ligji vetë të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të plotësojë standardin e "ligjshmërisë' së parashikuar nga Konventa, një standard që kërkon që i gjithë legjislacioni të jetë mjaftueshmërisht i saktë që t'i lejojë personit, - nëse nevojitet, me këshillim përkatës – të parashikojë, deri në një nivel që është i arsyeshëm për rrethanat, pasojat që mund të japë një veprim i caktuar" (shih Baranoëski k. Polonisë, nr. 28358/95, § 52, ECHR 2000-III).

149. Gjykata thekson më tej se autoritetet duhet të plotësojnë gjithashtu dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm në proceset që lidhen me ndalimin (shih Van der Leer k. Holandës, vendimi i datës 21 shkurt 1990, Seritë A nr. 170-A, §§ 23-24; Wassink k. Holandës, vendimi

i 27 shtatorit 1990, Seritë A nr. 185-A, § 27; Erkalo k. Holandës, vendimi i datës 2 shtator 1998, 1998-VI, § 57).

150. Së pari u takon autoriteteve kombëtare, pa dyshim gjykatave, të interpretojnë dhe të zbatojnë legjislacionin e brendshëm. Gjithsesi, përderisa nën nenin 5 § 1 mospërputhshmëria me të drejtën e brendshme përbën një shkelje të Kushtetutës, del si rezultat, që gjykata të mund, dhe të ushtrojë një kompetencë të caktuar për rishikimin e një përputhshmërie të tillë (shih Benham k. Mbretërisë së Madhe, vendimi i datës 10 qershor 1996, Raportet 1996-III, § 41).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në çështjen në fjalë

151. Gjykata vë re se ankuesi u ndalua më 15 maj 2002 në pritje të rezultatit të proceseve të njohjes dhe të zbatimit në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal).

152. Gjykata duhet të sigurohet nëse kishte një bazë ligjore për ndalimin e ankuesit në setin e dytë të proceseve.

153. Gjykata vë re se në kohën e ndalimit të ankuesit më 15 maj 2002, proceset për njohjen dhe zbatimin e një dënimi të dhënë nga një gjykatë e huaj drejtoheshin nga nenet 512 dhe 514 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"). Sipas këtyre dispozitave, proceset duheshin çuar para gjykatave të rrethit pas një kërkese nga Ministria e Drejtësisë "pasi të ishte njoftuar për zbatimin e një vendimi të huaj në lidhje me një qytetar shqiptar". Për më tepër, vlefshmëria dhe zbatimi i një vendimi të huaj ishin të kushtëzuar, *inter alia*, në pëlqimin e dhënë nga personi në fjalë (neni 514 (e) – shih paragrafin 72 më lart).

154. Gjykata e rrethit dhe gjykata e Apelit, në vendimet e tyre të 20 qershorit 2002 dhe 24 korrikut 2004, gjetën që natyra e domosdoshme e pëlqimit të lartpërmendur nuk i linte asnjë të drejtë gjykatave të zbatonin nenin 512 dhe 514 pa pëlqimin e ankuesit. Këto gjykata ishin të mendimit se çdo rast i mosdhënies së pëlqimit nga ankuesi e bënte vendimin italian të pazbatueshëm në Shqipëri, dhe, si rezultat, nuk kishte bazë ligjore për ndalimin e tij (shih paragrafët 29 dhe 30 më lart).

155. Ndërsa proceset para Gjykatës së Apelit të Tiranës ishin pezull, ligji nr. 8813 i datës 13 qershor 2002 (i cili hyri në fuqi më 11 qershor 2002) i bëri disa ndryshime KPP-së, inter alia, duke shfuqizuar pëlqimin e lartpërmendur të përfshirë në nenin 514 (e). Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm apeloi në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar zbatimin e ligjit të ndryshuar rishtazi në çështjen në fjalë. Gjykata e Lartë i jep juridiksion Kolegjeve të Bashkuara, duke e njohur atë si organizëm kompetent për të siguruar unifikimin e jurisprudencës.

156. Në vendimin e saj të 30 janarit 2003, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, vendosën të mos merrnin parasysh dispozitat e nenit 514 (e) pa referencë zyrtare në zbatueshmërinë e ligjit të ri. E njëjta qasje u mor dhe nga Gjykata Kushtetuese, në proceset e rigjykimit, që ishte organi kompetent gjyqësor për të vlerësuar përputhshmërinë e dispozitave të brendshme me Kushtetutën, e cila, në vendimin e saj të datës 12 korrik 2004, pranoi arsyetimin e Gjykatës së Lartë (shih paragrafët 46 dhe 47 më lart).

157. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese e kufizuan veten në konsiderimin e dispozitës së KPP-së "së vjetër" në nenin 514, si të papërshtatshme dhe u shprehën se mund të parashikohej një bazë ligjore nga normat gjerësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare në përputhje me parimin e vullnetit të mirë dhe të reciprocitetit. Ato iu referuan të dy traktateve, përkatësisht Konventës Europiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar dhe Protokollit Shtesë të tij.

158. Gjithsesi, Konventa Europiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale nuk kishte hyrë në fuqi në asnjërin nga vendet në kohën në fjalë (shih paragrafin 90 më lart). As Gjykata e Lartë dhe as Gjykata Kushtetuese nuk sugjeruan se ndonjëra nga konventat ishte në fuqi në Shqipëri.

Në fakt, kërkimi i Gjykatës së Lartë për një bazë ligjore më të përshtatshme për ndalimin e ankuesit, e çoi atë në importimin në dispozitat e së drejtës së brendshme të dispozitave të instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare të cilat nuk kishin hyrë ende në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

159. Duke pasur parasysh vendimin e mësipërm, ndalimi i ankuesit nuk u bazua në dispozitat e KPP-së, të ndryshuar nga dispozita e re që shfuqizonte kërkesën për pëlqimin. Në të vërtetë, gjykatat kombëtare në vetvete ishin të pasigurta në lidhje me çështjen se kë version të KPP-së të zbatonin në rastin e ankuesit. Në çdo rast, nëse gjykatat kombëtare do të kishin vendosur për përdorimin e dispozitës së re, kjo do të kishte çuar në vlefshmërinë prapavepruese të ndalimit të ankuesit.

160. Për gjykatën, baza ligjore e gjetur më në fund nga Gjykata e Lartë zor se mund të thuhet se

plotëson komponentët cilësorë të kërkesës së "ligjshmërisë" në lidhje me ndalimin e ankuesit dhe konvertimit të dënimit të dhënë nga gjykatat italiane.

161. Si rezultat, nuk mund të thuhet se ankuesi ishte në gjendje të parashikonte, deri në një shkallë që ishte e arsyeshme për rrethanat, se ndalimi i tij që prej 15 majit 2002 dhe konvertimi në Shqipëri i dënimit të dhënë nga gjykatat italiane, ishte në përputhje me një procedurë të parashikuar nga e drejta e brendshme.

162. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

163. Ankuesi pretendon paligjshmërinë e proceseve që lidhen me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit me burgim të dhënë nga gjykatat italiane. Ai u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet … brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj…"

164. Gjykata vlerëson se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Si rezultat, ajo duhet të deklarohet e pranueshme. Gjithsesi, duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, sipas nenit 5 § 1, Gjykata mendon se ajo nuk duhet të shqyrtojë veçmas nëse faktet çojnë në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 7 § 1 TË KONVENTËS

165. Ankuesi u ankua më tej se gjykatat e brendshme, duke mos zbatuar një dispozitë më të lehtësuar, të prezantuar menjëherë për veprën në fjalë dhe duke parashikuar një kohë më pak të rëndë burgimi, kanë shkelur dispozitat e nenit 7 të Konventës, e cila në pjesët përkatëse parashikon si më poshtë:

"1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale."

166. Qeveria e kundërshtoi këtë argument, duke thënë se kjo dispozitë nuk ishte e aplikueshme në rrethanat e çështjes.

167. Sipas jurisprudencës së gjykatës, neni 7 i Konventës përqafon në përgjithësi parimin se vetëm ligji mund të përkufizojë një krim dhe të parashikojë një dënim (nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe ndalon në veçanti zbatimin prapaveprues të ligjit penal, kur kjo gjë është në dëm të të akuzuarit (shih Kokkinakis k. Greqisë, vendimi i datës 25 maj 1993, Seritë A nr. 260-A, f. 22, § 52).

168. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vë re se gjykatat shqiptare zbatuan dënimin me burgim të përjetshëm për ankuesin, siç parashikohet nga ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, pavarësisht nga fakti se, dënimi i zbatueshëm për të njëjtën vepër penale në kohën e dënimit nga gjykatat shqiptare ishte shumë më i favorshëm për të.

169. Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme të cilave iu referua neni 35 i Konventës i detyron ata që kërkojnë ta çojnë çështjen kundër shtetit para gjykatës të përdorin së pari mjetet e parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor (shih Handyside k. Mbretërisë së Madhe, 7 dhjetor 1976, § 48, Seritë A nr. 24). Ankesat duhet të ishin bërë në organin përkatës të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat zyrtare dhe afatet kohore të parashikuara në të drejtën e brendshme, dhe, më tej, duhet të ishte përdorur çdo mjet procedural që mund të parandalojë shkeljen e Konventës (shih Cardot k. Francës, 19 mars 1991, § 34, Seritë A nr. 200).

170. Në rastin në fjalë, Gjykata vë re se ankuesi nuk ngriti ndonjë ankesë rreth dënimit të zbatueshëm penal në apelet e tij në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë ose Gjykatën Kushtetuese. Është për këtë arsye që asnjëra nga gjykatat më të larta nuk e shqyrtoi një ankesë të tillë.

171. Gjykata përfundon se ankuesi ka dështuar në shterimin e mjeteve të brendshme juridike, siç parashikohen në sistemin e brendshëm ligjor. Ajo, si rezultat, e rrëzon këtë ankesë, në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

V. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 34 TË KONVENTËS

172. Sipas ankuesit, transferimi i vonuar për në spital, pavarësisht nga masa e përkohshme që iu vu qeverisë sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, ka cenuar të drejtat e tij, të parashikuara në nenin 34 të Konventës.

173. Neni 34 i Konventës parashikon si më poshtë:

"Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose protokolleve të saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte."

174. Neni 39 i rregullores së Gjykatës thotë:

"1. Dhoma, ose, kur është e nevojshme, Kryetari i saj, me kërkesë të një pale ose të çdo personi tjetër të lidhur, ose me mocionin e saj, i njofton palët për masa paraprake që ajo i mendon se duhet të merren në interesa të palëve ose të kryerjes së duhur të proceseve para saj.

2. Për këto masa njoftohet Komiteti i Ministrave.

3. Dhoma mund të kërkojë informacion nga palët për çdo çështje që lidhet me zbatimit e çdo mase të përkohshme që ka dhënë ajo."

A. Parashtrimet e palëve

1. Qeveria

175. Qeveria parashtroi se masa e përkohshme e Gjykatës e datës 10 janar 2008 u është nisur menjëherë autoriteteve përgjegjëse shtetërore më 10 janar 2008 (Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Burgjeve), të cilat shfaqën angazhimin e tyre për të përmbushur vendimin e Gjykatës. Nga data 22 deri më 24 janar 2008, drejtuesit e lartë të autoriteteve përgjegjëse shtetërore bënë disa takime me qëllimin e marrjes së masave të nevojshme për të siguruar transferimin e ankuesit në spital.

176. Qeveria deklaroi se transferimi i ankuesit nga një burg i sigurisë së lartë, si ai i Peqinit, në një spital, ishte një sipërmarrje delikate, e cila bënte të nevojshme marrjen e masave të posaçme të sigurisë për mbrojtjen e jetës së ankuesit dhe të rendit publik në spital.

177. Qeveria theksoi refuzimin e ankuesit për t'u transferuar në spital më 25 janar 2008 me arsyetimin që ai kërkonte trajtim mjekësor me interferon beta, në vend të kryerjes së një ekzaminimi mjekësor. Sipas qeverisë, ankuesi refuzonte të hante atë ditë dhe kërkoi transferimin sërish në burgun e Peqinit. Më tej, qeveria parashtroi se vendimi për të administruar interferon beta duhej të merrej nga një grup mjekësh të specializuar. Nuk ishte mbledhur një grup i tillë mjekësh për të diskutuar çështjen e ankuesit.

178. Gjatë transferimit të tij në spital, qeveria vuri re se ankuesi ishte në gjendje të mirë fizike. Ai komunikonte lirshëm dhe lëvizte pa vështirësi.

2. Ankuesi

179. Ankuesi pretendonte se qeveria kishte dështuar plotësisht në marrjen e masave për zbatimin e masës së përkohshme të dhënë nga Gjykata. Sipas tij, nuk janë dhënë urdhra për ta transferuar atë në një spital.

180. Sipas pikëpamjes së ankuesit, qeveria ka dështuar në depozitimin e dokumenteve mbështetëse që justifikon argumentet e saj në lidhje me rrezikun e mundshëm të jetës së tij apo prishjes së rendit publik në spital si rezultat i transferimit. Ai kundërshtoi gjithashtu dhe mënyrën në të cilën ishin kryer ekzaminimet mjekësore dhe për procedurat e ndjekura. Ankuesi pretendon se nuk i janë bërë disa teste dhe se disa dokumente i ishin hequr nga dosja mjekësore.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e Përgjithshme

181. Neni 34 i Konventës u kërkon shteteve anëtare të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankuesit për të pasur akses në Gjykatë (shih Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë [GC], nr. 46827/99 dhe 46951/99, § 100, ECHR 2005-I).

182. Detyrimi në nenin 34 për të mos ndërhyrë në ushtrimin efektiv të së drejtës së individit për të bërë dhe për të ndjekur një ankesë para Gjykatës i jep individit një të drejtë me natyrë procedurale– që mund të pohohet në proceset e Konventës – të ndryshme nga të drejtat substantive të parashikuara në seksionin I të Konventës dhe të Protokolleve të saj (shih, për shembull, Shamayev e të Tjerë k. Gjeorgjisë dhe Rusisë, nr. 36378/02, § 470, ECHR 2005-III).

183. Në çështjen Mamatkulov dhe Askarov (e cituar më lart, §§ 104, 125 dhe 128), Gjykata vendosi se mospërputhshmëria me një masë të përkohshme e parashkruar në nenin 39 të rregullores së Gjykatës mund të çojë në shkelje të nenit 34 të Konventës.

184. Në Paladi k. Moldavisë ([GC], nr. 39806/05, 10 mars 2009) Gjykata deklaroi:

"87. Gjykata rithekson detyrimin e parashikuar në nenin 34 in fine që u kërkon Shteteve Kontraktuese të tërhiqen jo vetën nga ushtrimin e presionit ndaj ankuesit, por dhe nga çdo veprim ose mosveprim i cili, duke shkatërruar objektin e aplikimit, do ta bënte pa vlerë ose do të shmangte Gjykatën nga shqyrtimi i çështjes në procedurë normale (në të njëjtin vend., § 102). Është e qartë nga qëllimi i këtij neni, që është sigurimi i efektivitetit të së drejtës së individit për të kërkuar (shih paragrafin 86 më lart), se qëllimet ose arsyet që lidhen me veprimet ose mosveprimet në fjalë kanë pak lidhje kur vlerësohet nëse është respektuar neni 34 i Konventës (shih paragrafin 78 më lart). Ajo çfarë është e rëndësishme është nëse situata e krijuar si rezultat i veprimit ose mosveprimit të autoriteteve është në përputhje me nenin 34.

88. E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me përputhshmërinë me masat e përkohshme të parashikuara në nenin 39, pasi masa të tilla jepen nga Gjykata për qëllime të të siguruarit të efektivitetit të së drejtës së kërkesës së individit (shih paragrafin 86 më lart). Pra, neni 34 shkelet nëse autoritetet e një shteti Kontraktues nuk marrin masa të cilat mund të ishin marrë në mënyrë të arsyeshme në mënyrë që të përmbushen masat e dhëna nga Gjykata.

89. Më tej, Gjykata thekson se kur ka arsye të forta për rrezikun e një dëmi të pandreqshëm për gëzimin e njërës nga të drejtat themelore nga ankuesi, sipas Konventës, subjekti i masës së përkohshme është të ruhen dhe të mbrohen të drejtat dhe interesat e palëve në mosmarrëveshje para Gjykatës, në pritje të vendimit përfundimtar. Del nga natyra e masave të përkohshme se vendimi nëse ato duhet të jepen në një çështje të caktuar shpesh bëhet brenda një kohe të shkurtër, me qëllimin e shmangies së ndodhjes së dëmit të mundshëm të përnjëhershëm. Si rezultat, faktet e plota të çështjes shpesh mbeten të papërcaktuara derisa të vendosë Gjykata për themelin e çështjes të ankesës me të cilën lidhet masa. Pikërisht për qëllim të ruajtjes së aftësisë së Gjykatës për të dhënë një vendim të tillë pas një shqyrtimi efektiv të ankesës janë arsye pse jepen masa të tilla. Deri në atë kohë, mund të jetë e pashmangshme për Gjykatën të japë masa të përkohshme mbi bazën e fakteve, të cilat, pavarësisht nga bërja e një çështje *prima facie* në favor të rasteve të tilla, rrjedhimisht i shtohen ose sfidohen deri në pikën sa vënë në pyetje justifikimin e masave.

Për të njëjtat arsye, fakti që dëmi për të cilin masa e përkohshme është projektuar të parandalojë, rrjedhimisht del se nuk ka ndodhur pavarësisht nga paaftësia e shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme është po aq jo e përshtatshme për të vlerësuar nëse ky shtet i ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 34.

90. Si rrjedhim, nuk është e hapur për një Shtet Kontraktues të zëvendësojë vendimin e tij me vendimin e Gjykatës në verifikimin nëse ka ekzistues ose jo një rrezik i menjëhershëm dhe një dëm i pandreqshëm për një ankues në kohën kur jepet masa e përkohshme. Po ashtu, nuk u takon as autoriteteve të brendshme të vendosin për kufijtë kohorë për plotësimin e një mase të përkohshme ose për pikën deri në të cilën duhet të përmbushet masa. I takon Gjykatës të verifikojë përputhshmërinë me masën e përkohshme, ndërsa një shtet që mendon se ka materiale të afta për të bindur Gjykatën për të anuluar masën e ndërmjetme, e informojnë Gjykatën për këtë gjë (shih, mutatis mutandis, Olaechea Cahuas k. Spanjës, nr. 24668/03, § 70, ECHR 2006-X; Tanrıkulu k. Turqisë [GC], nr. 23763/94, § 131, ECHR 1999-IV; dhe Orhan k. Turqisë, nr. 25656/94, § 409, 18 qershor 2002).

91. Pika e nisjes për të verifikuar nëse një shtet i akuzuar ka përmbushur masën është vetë formulimi i vetë masës (shih, *mutatis mutandis*, analizën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për formulimin e masave të saj të brendshme dhe përputhshmërinë aktuale me të në LaGrand, cituar në paragrafin 62 më lart). Si rezultat, Gjykata shqyrton nëse shteti i akuzuar ka respektuar formulimin dhe frymën e masës së përkohshme që i është dhënë.

92. Në shqyrtimin e ankesës sipas nenit 34 në lidhje me dështimin e pretenduar të një Shteti Kontraktues për të respektuar masën e përkohshme, Gjykata, si rezultat, nuk do ta shqyrtojë nëse vendimi i saj për të zbatuar masa të përkohshme ishte i saktë. I takon qeverisë së akuzuar t'i dëshmojë Gjykatës së është respektuar masa e përkohshme, ose, në raste përjashtimore, se kishte një pengesë objektive që e pengoi qeverinë të merrte të gjitha hapat e arsyeshme të heqë pengesat dhe të mbajë të informuar Gjykatën rreth situatës."

2. Zbatimi i parimeve të sipër-përmendura në çështjen në fjalë

a) A kishte mospërputhshmëri në plotësimin e masës së përkohshme

185. Gjykata vë re se qeveria e akuzuar u informua zyrtarisht për masën e përkohshme të parashikuar nga neni 39 i rregullores së Gjykatës më 10 janar të 2008-ës me anë të një bisede telefonike

ndërmjet sekretarit dhe agjentit të qeverisë. Mesazhi u dërgua me anë të postës elektronike në mëngjesin e datës 11 janar 2008, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për ta dërguar atë me faks në mbrëmjen e datës 10 janar 2008 dhe në mëngjesin e datës 11 janar 2008.

186. Përmbajtja e masës së përkohshme përfshinte udhëzime për autoritetet e brendshme për ta transferuar ankuesin në spital për ekzaminime mjekësore dhe trajtimin e duhur. Pavarësisht nga njoftimi për masën e përkohshme jo më vonë se mëngjesin e datës 11 janar 2008, autoritetet vendore e transferuan ankuesin në spital për ekzaminime mjekësore vetëm me datën 28 janar 2008.

187. Del se masa e përkohshme nuk u respektua për një periudhë kohore prej shtatëmbëdhjetë ditësh.

b) Justifikimi për mosplotësimin e masës së përkohshme

188. Gjykata tani do të përcaktojë nëse ka pasur pengesa objektive që e penguan qeverinë të përmbushte masën e përkohshme dhe nëse qeveria mori të gjitha masat e arsyeshme për të hequr pengesat dhe për të mbajtur Gjykatën të informuar rreth situatës (shih Paladi, cituar më lart, § 92.) Gjykata do të marrë parasysh sjelljen e ankuesit dhe kushtet e tij mjekësore në lidhje me veprimet e qeverisë për të përmbushur masën e përkohshme.

189. Qeveria parashtroi se transferimi i ankuesit në spital kërkonte marrjen e masave të sigurisë dhe koordinim ndërmjet institucioneve të ndryshme të brendshme.

190. Gjykata rithekson se masat e përkohshme duhet të respektohen si në rastet e çështjeve emergjente (shih Paladi, të cituar më lart, § 98). Në këtë aspekt, ajo vë re se nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që dëshmon se autoritetet vendase ndërmorën ndonjë veprim nga data 11 janar deri në datën 24 janar 2008. Pavarësisht nga argumenti i qeverisë në lidhje me masat e sigurisë që duhet të merren në rast të një transferte të tillë, Gjykata dyshon se ishte e pamundur për autoritetet e brendshme të organizonin takime urgjente menjëherë pas njoftimit të masës së përkohshme për qeverinë e akuzuar. Që kur autoritet kryesore ishin informuar nga agjenti i qeverisë rreth masës së përkohshme të Gjykatës në mëngjesin e datës 11 janar 2008 (shih paragrafin 66 më lart), Gjykata nuk sheh asnjë justifikim për vonesën për të kryer takimet e nevojshme. Ajo vë re me shqetësim se takimet e para janë mbajtur vetëm nga data 22 deri më 24 janar 2008. Për më tepër, qeveria dështoi në mbajtjen e Gjykatës të informuar rreth përputhshmërisë me masën e përkohshme gjatë gjithë kësaj periudhe.

191. Si rezultat, dhe pavarësisht nga urgjenca dhe serioziteti i masës së përkohshme të datës 10 janar 2008, autoritetet e brendshme treguan mungesë angazhimi për të ndihmuar Gjykatën në parandalimin e ndodhjes së dëmeve të pariparueshme. Sjellje të kësaj natyre janë të papërputhshme me detyrat që parashikohen për Shtetet Kontraktuese sipas nenit 34 në lidhje me kapacitetin e tyre për të respektuar masat e përkohshme me shpejtësinë e kërkuar (shih Paladi, cituar më lart, § 97).

192. Në lidhje me sjelljen e ankuesit, Gjykata vlerëson se ai ishte përgjegjës për një vonesë prej maksimumit prej tri ditësh (shih paragrafin 70 më lart). Gjykata e sheh me keqardhje sjelljen e ankuesit në kohën kur masa e përkohshme ishte marrë në mënyrë që të verifikohej niveli i vërtetë i gjendjes së tij. Gjithsesi, ajo nuk e gjen të bazuar asnjë vonesë tjetër për shkak të fajit të tij.

193. Në vëzhgimet e saj, qeveria parashtroi se gjendja e mirë fizike e ankuesit tregoi se nuk kishte asnjë rrezik aq të madh sa ishte menduar më parë.

194. Gjykata thekson se nuk ka shpjegim të pranueshëm për paaftësinë e autoriteteve të brendshme për të marrë veprime të menjëhershme për të respektuar masën e përkohshme. Ajo kujton se dëmi që masa e përkohshme është projektuar të parandalojë del rrjedhimisht se nuk ka ndodhur, pavarësisht nga paaftësia e shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme, është i pavlerë në vlerësimin nëse Shteti i akuzuar i ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 34 (shih Paladi, cituar më lart, § 89).

195. Gjykata përfundon se vonesa e autoriteteve të brendshme në përmbushjen e masës së ndërmjetme në fjalë, në mungesë të çdo justifikimi objektiv, përben shkelje të nenit 34 të Konventës.

VI. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

196. Së fundmi, ankuesi pretendon se në deklarimin e apelimit të tij për proceset e rigjykimit si të papranueshme *de plano* më 30 janar 2004, pa dhënë arsye, Gjykata e Lartë ka shkelur nenin 2 të protokollit nr. 7 të Konventës, i cili parashikon:

"1. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimin. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.

2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij."

197. Gjykata, në fund, është e mendimit se ankuesi, në thelb po ankohet për paaftësinë e gjykatave të brendshme për të dhënë arsye për vendimin e tyre, një ankesë e shqyrtuar më drejt në nenin § 1 të Konventës sesa në nenin 2 të protokollit nr. 7.

198. Gjykata rithekson se e drejta që i garantohet një ankuesi sipas nenit 6 të Konventës përfshin të drejtën për të pasur arsye për vendimet e dhëna nga një gjykatë e brendshme në çështjen e tij. Gjithsesi, detyrimi korrespondues për një gjykatë të brendshme për të dhënë arsye për vendimet e tij nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument të dhënë nga një ankues. Shkalla në të cilën zbatohet detyra për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit në fjalë (shih, për shembull, Helle k. Finlandës, vendimi i datës 19 dhjetor 1997, Raportet 1997-VIII, f. 2929, § 56).

199. Gjykata vë re se në këtë aspekt ankuesi apeloi në Gjykatën e Lartë mbi bazën se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin të paplota në bazë ligjore. Gjykata është e mendimit se arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në formulën e vendimit të saj *de plano*, gjithsesi, dëshmojnë në mënyrë të pashprehur se ankuesi nuk kishte përdorur njërën nga pikat e ligjit që bie brenda objektit të lënies së procesit të apelimit. Gjykata vëren se, kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk ekzistojnë, një arsyetim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, Nerva k. Mbretërisë së Madhe (dhjet.), nr. 42295/98, 11 qershor 2000).

200. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykata është e mendimit se ankesa është shprehimisht e keqbazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3, dhe si rezultat është e papranueshme në përputhje me nenin 35 § 4.

VII. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

201. neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

202. Ankuesi pretendoi 50 000 euro (EUR) për dëme jomateriale.

203. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e ankuesit, por nuk parashtroi asnjë argument të lidhur me shumën e pretenduar prej tij.

204. Gjykata thekson se, në kuadrin e zbatimit të vendimeve në përputhje me nenin 46 të Konventës, një vendim në të cilin identifikohet shkelje, i ngarkon shtetit të akuzuar një detyrim ligjor nën dispozitën e përfundimit të shkeljes dhe të ndreqjes së pasojave në mënyrë të tillë që të ndreqet sa më shumë të jetë e mundur situata që ekzistonte para shkeljes. Nëse, nga ana tjetër, e drejta kombëtare nuk lejon – ose lejon pjesërisht – riparim për pasojat e shkeljes, neni 41 i jep kompetenca Gjykatës t'i japë palës së dëmtuar atë shumë që konsiderohet prej saj si e kënaqshme. Rezulton, *inter alia*, se një vendim në të cilin Gjykata identifikon një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe vendos për shtetin e akuzuar një detyrim ligjor jo vetëm për të paguar palët e lidhura me shumat e kërkuara si mënyra për të realizuar kënaqësinë e drejtë, por dhe të për zgjedhur, në varësi të mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme, dhe/ose, nëse nevojiten, masat specifike që duhen zbatuar në rendin e brendshëm ligjor për t'i dhënë fund shkeljes së identifikuar nga gjykata dhe për të bërë tërë ndreqjen e nevojshme të pasojave në mënyrë të tillë që të ndreqë aq sa është e mundur situatën e ta kthejë atë në nivelin e situatës që ekzistonte para shkeljes (shih Ilaşcu dhe të Tjerë k. Moldavisë dhe Rusisë [GC], nr. 48787/99, § 487, ECHR 2004-VII; Assanidze k. Gjeorgjisë [GC], nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II; Maestri k. Italisë [GC], nr. 39748/98, § 47, ECHR 2004-I; Menteş dhe të Tjerët k. Turqisë (Neni 50), vendimi i datës 24 Korrik 1998, Raportet 1998-IV, f. 1695, § 24; dhe Scozzari dhe Giunta k. Italisë [GC], nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII).

205. Gjykata thekson se ka gjetur shkelje të disa dispozitave të Konventës nga shteti i akuzuar. Ankuesit i është dhënë trajtim i papërshtatshëm mjekësor, në kundërshtim me nenin 5, në lidhje me grupin e dytë të proceseve që lidheshin me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës Italiane. Gjykata ka vendosur gjithashtu se është shkelur neni 34 i Konventës.

206. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 të Konventës, Gjykata vë re se ankuesi kërkon dëme jomateriale vetëm në lidhje me periudhën nga 15 maji 2002 deri më 29 dhjetor 2003, datë nga e cila burgosja e tij drejtohej nga vendimi i gjykatës së rrethit në lidhje me proceset penale.

207. Gjykata vë re se ankuesi kërkon dëmshpërblim vetëm për dëme jomateriale. Në këtë mënyrë, ajo nuk i jep ankuesit dëmshpërblim për dëme materiale. Në lidhje me dëmin jomaterial të pretenduar, Gjykata është e mendimit se është e arsyeshme të mendohet se ankuesi ka pësuar stres, ankth dhe frustrim, të shkaktuar nga përkeqësimi i gjendjes së tij shëndetësore, që u përkeqësua më tej me burgimin e tij të paligjshëm për më shumë se një vit dhe shtatë muaj. Duke vendosur mbi një bazë të barabartë, Gjykata i jep ankuesit EUR 8 000 në lidhje me dëmtimin jomaterial.

B. Kostot dhe shpenzimet

208. Ankuesi pretendoi edhe 7,550 euro për kostot dhe shpenzimet për marrjen e një vlerësimi mjekësor të specializuar dhe për shpenzimet e Gjykatës. Ai parashtroi një ndarje të detajuar sipas zërave për të mbështetur pretendimet e tij.

209. Qeveria e kontestoi pretendimin e ankuesit pa parashtruar asnjë argument.

210. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, ankuesi ka të drejtë të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet e tij vetëm për aq kohë që këto shpenzime dëshmohen se janë kryer aktualisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme në masë. Në rastin në fjalë, në lidhje me informacionin në dispozicion dhe të kritereve të sipërpërmenduara, Gjykata e mendon të arsyeshme të vendosë t'i japë ankuesit 7 000 euro për të mbuluar kostot sipas zërave.

C. Niveli i interesit

211. Gjykata është e mendimit se është e drejtë që niveli i interesit për mospagimin të bazohet në kufirin marxhinal të nivelit të huasë të Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NË MËNYRË UNANIME:

1. Deklaron ankesat në lidhje me nenin 3 të Konventës, nenin 5 § 1 të Konventës dhe nenin 6 § 1 të Konventës të pranueshme dhe pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme;

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me trajtim të papërshtatshëm mjekësor për ankuesin gjatë burgimit të tij;

3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me ndalimin e ankuesit nga data 15 maj 2002 deri më 29 dhjetor 2003;

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet veçmas nëse ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me proceset që kanë të bëjnë me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi të marrë nga një vendim i Gjykatës së Apelit të Milanos;

5. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 34 të Konventës;

6. Vendos

a) që shteti i akuzuar t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data e daljes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 8,000 euro (tetë mijë euro) për dëme jo materiale dhe 7,000 euro (shtatë mijë euro) për kosto dhe shpenzime, të konvertuara në monedhën e shtetit të akuzuar, në kursin e këmbimit në datën e pagesës, plus çdo taksë që mund të vihet;

b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind;

7. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit.

Bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 7 korrik 2009, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 11.8.2009
Doli nga shtypi më 11.8.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë